

# FIALËT E URTA TË SOLLOMONIT

## FIALË TË URTA

### KREI 1

<sup>1</sup> Fialët' e urta të Sollomonit, të birit Dhavidhit, mbëretit Israilit,

<sup>2</sup> që të njohë (njeriu) urtësi e dituri, që të kupëtonjë fialë urtësie,

<sup>3</sup> që të marrë mësim urtësie, e së drejte, e gjyqi, e drejtërie,

<sup>4</sup> që t'u ap kupëtim të mituret, e mësim e të shquarë të rinjet.

<sup>5</sup> I urti tuke dëgjuarë do të bënetë më i urtë, edhe i kupëtuarshimi do të fitonjë dituri të guvernuari,

<sup>6</sup> që të kupëtonjë fialë t'urtë, e fialë t'errëtë, ligjërata të urtësh, e fialë të fshehëta t'atyreve.

<sup>7</sup> Kryet' e ditorisë është frik' e Zotit, të marrëtë shpërnderonjënë ditorinë e mësimnë.

<sup>8</sup> Dëgjo, o biri im, mësimn' e t'yt-et, edhe mos hith tej nomn' e s'at-ëme.

<sup>9</sup> Sepse këto (do të jenë) kurorë gazesh ndë kryet tënt, edhe qafore rreth qafësë s'ate.

<sup>10</sup> Biri im, ndë daçinë fajtorëtë të të gënjenjënë, të mos duaç;

<sup>11</sup> ndë thënçinë: Eja bashkë me ne, le të bëjmë pritë për gjak, le të mendojmë të keqe papunë kundrë të pafajmit,

<sup>12</sup> le t'i përpim' ata të gjallë, posi hadhi, edhe të tërë posi ata që sbresënë ndë gropët;

<sup>13</sup> do të gjëjmë ç'do gjë të paçimuarë, do të mbushëmë shtëpitë t'ona me plaçka;

<sup>14</sup> vërë shortënë tënde ndë mest t'ënë, le të jetë një kuletë ndër ne të gjithë;

<sup>15</sup> biri im, mos ec' udhësë bashkë me ata, hiq këmbënë tënde nga udhët' e atyreve,

<sup>16</sup> sepse këmbët' e atyreve sulenë mbë të keqet, edhe nxitonenë për të derdhurë gjak.

<sup>17</sup> Sepse kot ndehetë rrietë përpara sysh ç'do shpesi.

<sup>18</sup> Sepse këta bënjënë pritë kundrë gjakut tyre, mendonjënë të keqe për jetën' e tyre.

<sup>19</sup> Të tilla (jan') udhët e çdo lakëmonjësi: (lakërimi) ngre jetën' e atyreve që janë pushtuarë nga ay.

<sup>20</sup> Urtësia klëthet jashtë, nxier zën' e saj ndëpër rrugat,

<sup>21</sup> thërret mbi kryet të tregjevet, ndëpër të hyrat të dyeret; flet fialët' e saj ndëpër qytet, (e thotë):

<sup>22</sup> Gjer kurë, o të marrë, do të doni marrësinë, edhe përqeshësitë do të kënaqenë me të përqeshurat' e tyre, edhe të pamëntë do të mërztinjënë të kupëtuarëtë?

<sup>23</sup> Kthehi ndë të qërtuarët t'im, na unë tek do të derth frymënë t'ime mbi ju, do t'u bënj të kupëtoni fialët' e mia.

<sup>24</sup> Sepse unë thërrisnjam, po ju nukë dëgjonitë; ndenjam dorënë t'ime, po asndonjë nukë mbante vesh,

<sup>25</sup> po hidhitë tej gjithë këshillet' e mia, edhe nuk priritë qërtimet' e mia;

<sup>26</sup> edhe unë do të qesh për prishëjenë tuaj, do të gëzonem, kur t'u vinjë frika.

<sup>27</sup> Kur t'u vinjë frika posi shkretim, edhe prishëja juaj të suletë posi erë shakulli, kur të vinjënë mbi ju shtrëngimi e ngushtimi,

<sup>28</sup> atëherë do të më thërrësënë, po nukë do të përgjegjem; do të më kërkonjë në shpejt, po nukë do të më gjënjënë.

<sup>29</sup> Sepse mërzitnë kupëtimnë, edhe nukë sgojthnë frikën' e Zotit,

<sup>30</sup> nukë deshnë këshillet' e mia, hothnë tej gjithë qërtimet' e mia,

<sup>31</sup> përandaj do të hanë nga pemët' e udhësë tyre, edhe do të nginjenë nga mendimet' e këqia të tyre.

<sup>32</sup> Sepse marrësia e të marrëvet do të vrasë ata, edhe pakujdesëja e të pamëntëvet do t'i shuanjë ata.

<sup>33</sup> Po ay që më dëgjon mua, do të rrijë pa frikë, edhe do të prëhetë, pa pasurë frikë ndonjë të keqeje.

## KREI 2

<sup>1</sup> Biri im, ndë priç fialët' e mia, edhe ndë vlofsh porosit' e mia ndë vetëhet tënde,

<sup>2</sup> që t'i mbash vesh diturisë, edhe të unjç zemërënë tënde ndë urtësit,

<sup>3</sup> ndë thërritç diturinë, edhe të gresh zënë tënt ndë urtësit,

<sup>4</sup> ndë kërkofsh atë posi argjënt, edhe ndë kërkofsh atë posi thesarë të fshehurë,

<sup>5</sup> atëherë do të kupëtonjç frikën' e Zotit, edhe do të gjënjç të njohurit' e Perëndisë.

<sup>6</sup> Sepse Zoti ep dituri, prej golës' ati del mëndëje e urtësi.

<sup>7</sup> Vlon shpëtim për të dreitët, është mburonjë mb' ata që ecënjënë dreitë,

<sup>8</sup> tuke mbaruar' udhët' e dreitërisë, edhe tuke ruajtur' udhën' e të dreitëvet ti.

<sup>9</sup> Atëhere do të kupëtonjç dreitëri, e gjyqë, e të dreitë, e ç' do udhë të mirë.

<sup>10</sup> Ndë hyftë urtësia ndë zemërët tënde, edhe të kupëtuarëtë të kënaqnjë shpirtinë tënt,

<sup>11</sup> këshillej' e dreitë do të ruanjë, urtësia do të të mbanjë,

<sup>12</sup> që të të shpëtonjë nga udh' e ligë, nga njeriu që flet gaba,

<sup>13</sup> të cilëtë lënë mbë-nj'-anë udhët' e dreitërisë, që të ecënjënë nd' udhët t'errësirësë,

<sup>14</sup> të cilëvet u pëlqen të bënëjnë keq, edhe gëzonenë, ndë shtrembërit të së keqesë,

<sup>15</sup> udhët' e atyreve janë të shtrembëta, edhe të ecurit' e atyre të përthyerë,

<sup>16</sup> që të të shpëtonjë nga gruj' e huajë, nga e huaja që të përkëdhel me fialët' e saj,

<sup>17</sup> e cila hoqi dorë nga i dashuri i vajzërisë saj, edhe harroi dhiatën' e Perëndisë saj,

<sup>18</sup> sepse shtëpia e asaj sbret ndë vdekëjet, edhe çapat' e asaj ndër të vdekurit;

<sup>19</sup> gjithë sa hynjënë tek ajo nukë kthenenë, as nukë marrënë më udhët' e jetësë;

<sup>20</sup> që të ecëjsh mb' udhët të mirëvet, edhe të ruajsh rrugat' e të dreitëvet.

<sup>21</sup> Sepse të dreitëtë do të rrinë ndë dhet, edhe të sosuritë do të mbetenë nd' atë.

<sup>22</sup> Po të pabesëtë do të këputenë nga dheu, edhe të panomëtë do të shkulenë prej ati.

## KREI 3

<sup>1</sup> Biri im, mos harronjç nomët' e mi, edhe zemëra jote le të ruanjë porosit' mia,

<sup>2</sup> sepse do të shtonjënë te ti dit të gjata, e vite jete, e paqtim.

<sup>3</sup> Përdëllimi edhe e dreita le të mos të lënë, lidh-i ato qark qafësë s'ate, gërvisht-i ato mbi rrasat të zemërësë s'ate;

<sup>4</sup> kështu do të gjënjç hirë e sy të mirë përpara Perëndisë e njerëzet.

<sup>5</sup> Shpëre mbë Zotinë me gjithë zëmërënë tënde, edhe mos u mba ndë mëndëjet tënde;

<sup>6</sup> mbë gjith' udhët e tua njih atë, edhe ay do të drejtonjë çapat' e tua.

<sup>7</sup> Mos kujto vetëhenë tënde për të diturë; ki frikë Zotit, edhe priru nga e keqeja.

<sup>8</sup> (Këjo) do të jetë mjekësi ndër dejet të tu, edhe palcë ndër eshtrat të tua.

<sup>9</sup> Ndero Zotinë me pasëjenë tënde, edhe me të lashtat' e gjithë drithit tënt,

<sup>10</sup> edhe do të mbushenë koshet' e tu plot, edhe koritat' e tua do të mbushenë përbuzë me verë të re.

<sup>11</sup> Biri im, mos hi thuj tej mësimin' e Zotit, edhe të mos të vinjë rëndë kur të qërtonesh prej ati,

<sup>12</sup> sepse Zoti qërton atë që do, sikundër edhe ati të birrë që pëlqen.

<sup>13</sup> Lum ay njeri (që) gjeti dituri, edhe ay njeri (që) fitoi urtësi,

<sup>14</sup> sepse tregjetia e asaj (është) më e mirë se tregjetia e argjëndit, edhe fitimi i asaj (më i mirë) se ari i këthiellëtë.

<sup>15</sup> Është më e nderëshime se gurët' e paçimuarë, edhe gjithë sa të dëshëronjë nukë jan' aqë të vëlyera sa ajo.

<sup>16</sup> Dit të gjata (janë) mbë të diathtë t'asaj; mbë të mëngjërë t'asaj (është) pasëje e lavdi.

<sup>17</sup> Udhët' e asaj janë të gasçime, edhe gjithë rrugat' e asaj (janë) paqtim.

<sup>18</sup> Është dru jete ndër ata që e pushtonjë, edhe lum ata që mbahenë prej asaj.

<sup>19</sup> Me anë të ditorisë Zoti themelosi dhenë, forcoi qiejëtë me urtësi.

<sup>20</sup> Me anë të mëndëjes' ati u hapnë avysetë, edhe retë pikonjë, edhe vesë.

<sup>21</sup> Biri im, le të mos mërgonenë (këto) nga syt' e tu, ruaj këshille të dreitë e urtësi,

<sup>22</sup> edhe do të kesh jetë ndë shpirt tënt, edhe hirë ndë qafët tënde.

<sup>23</sup> Atëherë do t'ecënjë udhësë tënde pa frikë, edhe këmba jote nukë do të pengonetë.

<sup>24</sup> Kur të biesh të flësh nukë do të tristonjë, po do të biesh, edhe gjumi yt do të jet' i ëmbëlë.

<sup>25</sup> Nukë do të trembesh nga frika e papandehurë, as nga humbëj' e të pabesëvet, kur të vinjë përsipërë,

<sup>26</sup> sepse Zoti do të jetë shpëresa jote, edhe do të ruanjë këmbënë tënde të mos zihetë.

<sup>27</sup> Mos ua kurse të mirënë atyreve që duhetë, kur e ke ndë dorët tënde t'e bënjë.

<sup>28</sup> Mos i thuaj t'afërëmit tënt: Shko edhe kthenu, edhe nesërë do t'ap, kur e ke me vetëhe.

<sup>29</sup> Mos mendo të keqe kundër t'afërëmit tënt, kur ay të ka zënë besë e rri bashkë me ty.

<sup>30</sup> Mos zihu me njeri pa ndonjë punë, ndë qoftë se s'të ka bërë ndonjë të keqe.

<sup>31</sup> Mos i ki zëli njeriut rrëmbyershim, edhe mos s'gjith ndonjë prej udhëvet ati,

<sup>32</sup> sepse Zotit i vien të ndohëtë nga shtrembëria, edhe të fshehëtët' e ati (sbulonetë) ndër të dreitëtë.

<sup>33</sup> Mallëkimi i Zotit (është) ndë shtëpit të pabesit, po (ay) bekon vëndin' e të dreitëvet.

<sup>34</sup> Me të vërtetë ay u del kundër madhështorëvet, po të përunjëtëvet u ep hirë.

<sup>35</sup> Të urtëtë do të trashëgonjë lavdi, po të lartët' e të marrëvet do të jetë turpëri.

## KREI 4

<sup>1</sup> Dëgjoni, o djem, mësim ati, edhe mbani vesh të xëni urtësi.

<sup>2</sup> Sepse u ap juve mësim të mirë: mos hiqni dorë nga nomi im.

<sup>3</sup> Sepse edhe unë qeshë i biri t'im-et, i dashur' e i vetëm përpara simëje,

<sup>4</sup> edhe më mësonte e më thosh: Le të mbajë zëmëra jote fialët' e mia, ruaj porosit' e mia, edhe do të rronjë.

<sup>5</sup> Fito dituri, fito urtësi, mos e harronjë, as mos priresh nga fialët' e golësë s'ime;

<sup>6</sup> mos hiq dorë nga ajo, edhe të ka për të ruajturë; doj-e atë, edhe të ka për të mbajturë.

- <sup>7</sup> Urtësia është më e para: fito urtësi, edhe më tepërë nga ç'do fitim, fito urtësi.
- <sup>8</sup> Merr-e përsipërë, edhe ajo do të të lartojë, do të të lëvdonjë, kur ta rroksh atë për qafe.
- <sup>9</sup> Do të vërë mbi kryet tënt rreth gazesh, do të t'apë kurorë lavdie.
- <sup>10</sup> Dëgjo, biri im, edhe prit fialët' e mia, edhe do të shumonenë vitet' e jetësë s'ate.
- <sup>11</sup> Të mëson udhën' e urtësisë, të fut ndër rruga dreitërie.
- <sup>12</sup> Kur të ecënijç, çapat' e tua nukë do të jenë të shtrënguara, edhe kur të sulesh, nukë do të pengonesh.
- <sup>13</sup> Rrok mësimnë, mos e lërë; ruaj-e atë, sepse është jeta jote.
- <sup>14</sup> Mos hyrë ndë rrugët të pabesëvet, edhe mos shko nd' udhët të këqijvet.
- <sup>15</sup> Largohu asaj, mos shkonijç nga ajo, priru nga ajo, edhe shko.
- <sup>16</sup> Sepse ata nukë flenë, ndë mos bëshinë të keqe; edhe u ngrihetë gjumi, ndë mos i vëncinë këmbënë ndonjëj.
- <sup>17</sup> Sepse hanë bukë pabesërie, edhe pinë verë shtrëngate.
- <sup>18</sup> Po udha e të dreitëvet është posi drita e shkëlqyerë, që vien tuke ndriturë shum' e më shumë, gjersa të bënëtitë ditë fare.
- <sup>19</sup> Udh' e të pabesëvet (është) posi errësira, nukë dinë se ku pengonenë.
- <sup>20</sup> Biri im, mbaju vesh ligjëratavet mia, kthe veshinë tënt mbë fialët të mia.
- <sup>21</sup> Le të mos largonenë nga syt' e tu, ruaj ato ndë zëmërit tënde,
- <sup>22</sup> Sepse është jetë për ata që gjënjën' ato, edhe mjekësi për gjithë trupin' e atyreve.
- <sup>23</sup> Ruaj zëmërenë tënde me ç'do farë të ruajturi, sepse nga ajo rrieth jeta.
- <sup>24</sup> Hiith lark teje golën' e shtrembëtë, edhe largo prej teje buzët' e shtrembëta.
- <sup>25</sup> Syt' e tu le të shohënë dreitë, edhe qerpallat' e tua le të drejtonetë përpara teje.
- <sup>26</sup> Pesho të ecurit' e këmbëvet tua, edhe gjith' udhët' e tua do të venë dreitë.
- <sup>27</sup> Mos u prirë mbë të diathtë a mbë të mëngjërë, largo këmbënë tënde nga e liga.

## KREI 5

- <sup>1</sup> Biri im, mba-ji vesh diturisë s'ime, kthe-ji veshin' urtësisë s'ime,
- <sup>2</sup> që të shikonijç urtësi, edhe buzët' e tua të ruanjënë kupëtim.
- <sup>3</sup> Sepse buzët' e (gruasë) huajë pikonjënë (posi) hojë mialte, edhe qiellëza e asaj (është) më e butë se vali,
- <sup>4</sup> po fundi i asaj (është) më i hidhurë se apsinthi, i hollë posi thikë me dy presëje.
- <sup>5</sup> Këmbët' e asaj sdërrmonjënë ndë vdekëjet, çapat' e asaj shkasënë ndë pisët.
- <sup>6</sup> Që të mos njohç udhën' e jetësë, të ecurat' e asaj janë të paqëndruara, (edhe) jo të shquara.
- <sup>7</sup> Dëgjomëni tashi pra, o djem, edhe mos dilni nga fialët' e golësë s'ime.
- <sup>8</sup> Largo udhënë tënde nga ajo, edhe mos u afro ndë derët të shtëpis' asaj,
- <sup>9</sup> që të mos apsh nderinë tënt të tierëve, edhe viet e tu të papërdëllyershimet;
- <sup>10</sup> që të mos nginjenë të huajëtë me pasëjenë tënde, edhe mundimet' e tu të hynjënë ndë shtëpi të huajë,
- <sup>11</sup> edhe ti të psherëtinjç më ndë funt, kur të tretetë mishi yt, edhe kurmi yt,
- <sup>12</sup> edhe të thuash: Qysh mërzita diturinë, edhe zëmëra ime hodhi tej qërtimetë,
- <sup>13</sup> edhe nuk' u dëgjojva zënë atyreve që më mësoninë, as nuk' u ktheva veshnë atyreve që më arrëseninë!
- <sup>14</sup> Për pakëzë desh rashë ndë ç'do të keqe, ndë mest të mpshtiellëjes' e të mbëledhëjesë.
- <sup>15</sup> Pi ujë prej sterrnësë s'ate, edhe prej ujit që buron nga pusi yt;

- <sup>16</sup> le të derdhenë jashtë gurrat' e tua, edhe rrëket' e ujëravet ndëpër rrugat,  
<sup>17</sup> ato le të jenë thjesht të tuatë, e jo të huajëvet bashkë me ty;  
<sup>18</sup> gurra jote le të jet' e bekuarë, edhe gëzohu bashkë me gruan' e të rit tënt.  
<sup>19</sup> Le (të jetë te ti) posi drere e dashurë, edhe (posi) kaprolle gazëtores; gjinjt' e asaj le të të ujitjënë mbë ç'do kohë; gëzoju kurdo ndë dashurit t'asaj.  
<sup>20</sup> Përse, o biri im, të k'anda të huajënë, edhe do të pushtonjç gjin' e së huajësë?  
<sup>21</sup> Sepse udhët' e njeriut (janë) përpara syvet Zotit, edhe ay peshon gjithë çapat' e ati.  
<sup>22</sup> Vetëm' ato panomit' e ati do të zënë të pabesinë, edhe do të shtrëngonetë me litarët' e falit ti.  
<sup>23</sup> Ky do të vdesë i pamësuarë, edhe nga shumica e marrësis' ati do të silletë andej e këtej.

## KREI 6

- <sup>1</sup> Biri im, ndë u bëre dorë-zënë për mikunë tënt, ndë i dhe dorënë të huajit,  
<sup>2</sup> u zure ndë lakt me fialët' e golësë s'ate, u zure me fialët' e golësë s'ate;  
<sup>3</sup> bën këtë pra, o biri im, edhe shpëto, sepse re ndë duart të mikut tënt; shko, mos u loth, edhe shtrëngo mikunë tënt.  
<sup>4</sup> Mos u apsh gjum syvet tu, as të dërmiturë qepallavet tua;  
<sup>5</sup> shpëto si kapruall prej dorësë gjahtorit, edhe si zok prej dorës' ati që zë zoq.  
<sup>6</sup> Shko te milingoneja, o purtesës, vështo udhët' e asaj, edhe bënu i urtë,  
<sup>7</sup> e cila pa krye, pa të parë, pa qiverrnitar,  
<sup>8</sup> bën gati ushqimn' e saj ndë verë, mbëleth të ngrënat' e saj ndë të korrët.  
<sup>9</sup> Gjer kurë do të flësh, o përtesës? Kurë do të ngrihesh nga gjumi?  
<sup>10</sup> Pak gjum, pak të dërmiturë, pak të pshtuellurë duartë mbë gjumët,  
<sup>11</sup> pastaj vien vobezia jote posi udhëtar i shpejtë, edhe nevola jote posi burr i armatosurë.  
<sup>12</sup> Njeriu i pavëlyerë, njeriu i lik, ecën me golë të shtrembëtë;  
<sup>13</sup> bën mbë sy me syt' e ti, flet me këmbët' e ti, mëson me gishtërat' e ti,  
<sup>14</sup> me zëmërë të shtrembëtë mendon të këqia mbë ç'do kohë, mbiell zënëje,  
<sup>15</sup> përëndaj papandehuraj i ka për të ardhurë humbëja, papandehuraj do të thërrmonetë pa (pasurë) mjekësi.  
<sup>16</sup> Zoti mërzit këto të gjashta, po më fort këto të shtata i ka të ndoh shpirti i ati:  
<sup>17</sup> sy madhështorë, gluhë gënjeshtare, edhe duar që derdhenë gjak të pafajm,  
<sup>18</sup> zemërë që mendon mendime të liq, këmbë që ecënjënë me vrap mbë të bërët të keqe,  
<sup>19</sup> deshmitar të rrem që flet gënjeshtërë, edhe atë që shtyn vëllezëritë të zihenë.  
<sup>20</sup> Biri im, ruaj porosin' e t'yt-et, edhe mos hith tej nomin' e s'at-ëme.  
<sup>21</sup> Mba-ji lidhurë përherë ndë zëmërët tënde, var-i ndë qafët tënde.  
<sup>22</sup> Kur të ecënjç, do të heqë udhënë; kur të flësh, do të të ruanjë; edhe (kur) të shkonesh, do të flasë bashkë me ty.  
<sup>23</sup> Sepse porosia është kandile, edhe nomi është dritë, edhe qërtimet' e diturisë (jan') udhë jete,  
<sup>24</sup> që të të ruanjë nga grua' e keqe, nga lajk' e gluhësë (gruasë) huajë.  
<sup>25</sup> Le të mos i teketë zemërësë s'ate për bukurin' e asaj, edhe le të mos të gjuanjë me qepallat' e saj.  
<sup>26</sup> Sepse për punë të kurvësë (bënetë njeriu) gjer mbë një copë buke, edhe grua' e burrit, (që është kurvë) gjuan shpirt të paçimuarë.  
<sup>27</sup> A munt të verë zjarr ndonjë ndë gji të ti, edhe të mos i digjenë rrobatë?  
<sup>28</sup> A munt të ecënjë ndonjë mbi thëngjij të dhezurë, edhe të mos i digjenë këmbëtë?

<sup>29</sup> Kështu (edhe) ay që hyn te gruaj' e të afërëmit ti; kush t'i qaset' afër' asaj, nukë do të dalë i pafajm.

<sup>30</sup> Nuk' e mërztinjtënë viedhësinë, kur vieth për të nginjurë shpirtin' e ti, kur ka uri,

<sup>31</sup> po ndë u zëntë, ka për t'i dhënë prapë për një shtatë, ka për të dhënë gjithë gjën' e shtëpisë ti.

<sup>32</sup> Po kush kurvëron me ndonjë grua, s'ka mënt; ay që bën këtë, vdierr shpirtin' e ti.

<sup>33</sup> Do të ketë plagë e turpëri, edhe turpëria e ati nukë do të shuhetë.

<sup>34</sup> Sepse zëlia është marrësi' e burrit, edhe s'i ka për të ardhurë keq ndë ditët të marrëjesë shpagimit.

<sup>35</sup> Nukë do të marrë asndonjë shpërblim, as nukë do të sbutetë, edhe ndë ja shumofsh dhuratatë.

## KREI 7

<sup>1</sup> Biri im, ruaj fialët' e mia, edhe vlo porosit' e mia mbë vetëhet tënde.

<sup>2</sup> Ruaj porosit' e mia, edhe do të rronjç; edhe nominë t'im, posi dritën' e syvet.

<sup>3</sup> Lidh-i ato mbë gishtërat të tu, gërvisht-i ato mbi rrasët të zemërësë s'ate.

<sup>4</sup> Thuaj diturisë: Ti je motëra ime, edhe kluaj urtësinë për fisinë (tënt),

<sup>5</sup> që të të ruanjtënë nga gruaj' e huajë, edhe nga e huaja që të përkëdhel me fialët' e saj.

<sup>6</sup> Sepse nga parathireja e shtëpisë s'ime shtiva sytë ndëpër trirët,

<sup>7</sup> e pashë ndër të marrët; vështrova ndër djemt një dialosh pa mënt,

<sup>8</sup> i cili shkonte rrugësë përënë çipit të atillë gruaje, edhe kish marrë udhënë që vinte ndë shtëpit t'asaj,

<sup>9</sup> vonë mbë të ngrysurit të ditësë, ndë t'errët të natësë, e nd' errësirë,

<sup>10</sup> edhe na tek përpiek me atë një grua (që e kish) të parëtë si kurvë, edhe zemërënë gënjeshtare,

<sup>11</sup> lomatare edhe e paturpshëme; këmbët' e asaj nukë qëndronjtënë ndë shtëpit t'asaj,

<sup>12</sup> tashi gjëndetë jashtë, tashi ndëpër rrugat, ri e prep mbë ç'do çip.

<sup>13</sup> Zë atë, edhe e uth, edhe me sy e faqe të paturpshëme i thot' ati:

<sup>14</sup> "Kam kurbane paqtimi, sot lava kushtimet' e mia,

<sup>15</sup> përëndaj dola të pres ty, sepse më mori malli të shoh syt' e tu, edhe të gjeta;

<sup>16</sup> kam shtruarë shtratinë t'im me pëlhura të linjta e të leshta qëndisurë me fije të Egjyftërisë;

<sup>17</sup> kam pshtymurë shtratinë t'im me smirrnë, e me allojë, e me qinamomë;

<sup>18</sup> eja le të dehemi me dashuri gjer mbë të sbardhëlyyerë, le të kënaqemi me dashuri,

<sup>19</sup> sepse nuk' është burri ndë shtëpi, ka marrë udhë të largë;

<sup>20</sup> mori një kuletë me argjënt ndë dorë të ti, do të kthenetë ndë shtëpi të ti pas kohe."

<sup>21</sup> Me shumë mjeshtëri të saj e gënjeu atë, me laikat' e buzëvet saj e hoqi pas vetiu.

<sup>22</sup> Përnjëherë vate pas asaj, posi kau kur vete të theretë, a posi dreri kur këcen ndë lakt,

<sup>23</sup> gjersa t'i depërtonjë mushkurinë shëgjetulla; posi zogu që vete me vrap ndë ngraçkët, edhe nuk' e di se është kundrë jetësë ti.

<sup>24</sup> Tashi pra dëgjomëni, o djem, edhe mbani vesh fialëtvet golësë s'ime.

<sup>25</sup> Zemëra jote le të mos priretë mb' udhët t'asaj, as mos kthenesh mbë rrugat t'asaj.

<sup>26</sup> Sepse ajo bëri shumë vetë e ranë të plagosurë, edhe burra të fortë janë vrarë prej asaj.

<sup>27</sup> Shtëpia e asaj është udhë pise, që të shpie ndër dhomat të vdekëjesë.

## KREI 8

<sup>1</sup> A nukë thërret dituria? Edhe nukë nxier zën' e saj urtësia?

<sup>2</sup> Qëndron ndë majtë të vëndeveve lartë përmbi udhët, ndë mest të udhëveve kryqe.

<sup>3</sup> Thërret afërë portave, ndë të hyrët të qytetit, ndë të hyrët të dyeret.

<sup>4</sup> U thërres juve, o njerës, edhe zëri im (lëshonëtë) te të bijet' e njerëzet.

<sup>5</sup> O të miturë, kupëtoni urtësi, edhe, o të marrë, fitoni zemërë të mënçëme.

<sup>6</sup> Dëgjoni, sepse do të flas punëra të larta, edhe buzët' e mia do të flasënë punëra të dreita.

<sup>7</sup> Sepse gurmazi im do të flasë të vërtetënë, edhe buzëvet mia u vien të ndohtë nga pabesëria.

<sup>8</sup> Gjithë fialët' e golësë s'ime janë me dreitëri, s'ka kobim a të shtrëmbëtë ndër ato;

<sup>9</sup> të gjitha janë të këthiellëta tek ay që kupëton, edhe të dreita ndër ata që gjënjënë mënt.

<sup>10</sup> Merrmëni mësimnë, e jo argjendinë, edhe mëndëjenë, më tepërë se arin' e sgjedhurë.

<sup>11</sup> Sepse dituria është më e mirë se gurët' e paçimuarë, edhe gjithë kafshat' e dëshëruarshime nukë janë kaqë të vëlyera, sa ajo.

<sup>12</sup> Unë dituria rri bashkë me urtësinë, edhe gjënj mëndëjen' e këshillevet urta.

<sup>13</sup> Frik' e Zotit (është) të mërzitnjë njeriu të keqenë; unë mërzit madhësthinë, e mburresënë, e udhën' e keqe, e golën' e shtrembëtë.

<sup>14</sup> Imëja është këshilleja, edhe siguria, unë (jam) mëndëja; imëja është fuqja.

<sup>15</sup> Me anë t'ime të mbëretëronjënë mbëretëritë, edhe të parëtë presënë gjyq të dreitë.

<sup>16</sup> Zotërinjtë zotëronjënë me anë t'ime, edhe njerëzit' e mëdhenj, gjithë gjykatësit' e dheut.

<sup>17</sup> Unë dua ata që më duanë, edhe ata që të më kërkonjënë do të më gjënjënë.

<sup>18</sup> Gjëja e lavdia është bashkë me mua, kafsha të mira që mbesënë, edhe dreitëria.

<sup>19</sup> Pemët' (e mia) janë më të mira se ari, edhe se ari i qëruarë; edhe drithi im, se argjëndi i sgjedhurë.

<sup>20</sup> Ecënj mb' udhë të dreitërisë, ndë mest të rrugavet gjyqit,

<sup>21</sup> që të bënj ata që më duanë të trashëgonjënë kafsha të mira, edhe të mbush thesarët' e atyreve.

<sup>22</sup> Zoti më kishte ndë kryet të udhëveve ti, përpara punëveve ti, që përpara jetësë.

<sup>23</sup> Që përpara jetësë më leu me val, që ndë kryet të herësë, pa qënë dheu.

<sup>24</sup> Linda kur nuk' ishin' avysatë, kur nuk' ishinë gurratë që buronjënë' ujëratë;

<sup>25</sup> përpara se të themelonëshinë maletë, përpara kodravet; unë linda,

<sup>26</sup> që kur s'kishte bërë dhenë, as fushatë, as majat' e dheravet botësë.

<sup>27</sup> Kur bënte gati qiejëtë, un' (ishnjam) atie; kur shënonte rreth përmbi faqet të avysësë,

<sup>28</sup> kur qëndronte retë lart, kur forconte gurrat' e avysësë;

<sup>29</sup> Kur vinte nomin' e ti ndë det, ujëratë të mos kapërceninë tej urdhëratën' e ati; kur urdhëronte themelet' e dheut,

<sup>30</sup> atëherë ishnjam afër' ati tuke punuarë; edhe unë ishnjam përditë të kënaqurit' (e ati), e gëzuarë përherë përpara ati,

<sup>31</sup> e gëzuarë ndë botët të dheut ati; edhe të kënaquritë t'im (ish) bashkë me të bijt e njerëzet.

<sup>32</sup> Tashi pra dëgjomëni, o djem, sepse të lumurë jan' ata që ruanjën' udhët' e mia.

<sup>33</sup> Dëgjoni mësim, edhe bëhi të diturë, edhe mos e hithni tej.

<sup>34</sup> Lum ay njeri që të më dëgjonjë, tuke ndenjurë squarë për ditë ndër dyert të mia, tuke priturë ndër pragjet të dyervet mia,

<sup>35</sup> sepse kush të gjënjë mua, do të gjënjë jetë, edhe do të marrë hirë prej Zotit.

<sup>36</sup> Po kush të fëlnjë tek unë, i bën keq shpirtit ti; gjith' ata që më mërztijnjë duanë vdekëje.

## KREI 9

<sup>1</sup> Dituria ndërtoi shtëpin' e saj, preu shtatë shtyllat' e saj,

<sup>2</sup> theri berrat' e saj, shturi verën' e saj, edhe bëri gati truvezën' e saj;

<sup>3</sup> dërgoi shërbëtoret' e saj, leçit mbi vëndet e lartë të qytetit:

<sup>4</sup> "Kush të jet' i marrë, le të këthenetë këtu"; (edhe) atyre që s'kanë mënt u thotë:

<sup>5</sup> "Eni, hani nga buka ime, edhe pini nga vera që shtyra;

<sup>6</sup> lini marrëzinë, edhe rroni, edhe ecëni dreitë mb' udhë të urtësisë."

<sup>7</sup> Kush mëson përqeshës turpëron vetëhen' e ti, edhe kush qërton të pabesë nxin faqen' e ti.

<sup>8</sup> Mos qërto përqeshës, që të mos të të mërztijnjë, qërto të urtinë, edhe do të të dojë.

<sup>9</sup> Ep-i (mënt) të diturit edhe do të bënetë më i diturë, mëso të dreitinë, edhe do të rritetë ndë mësim.

<sup>10</sup> Kryet' e diturisë është frik' e Zotit, edhe të njohurit' e Shënjtit (është) urtësia.

<sup>11</sup> Sepse me anët t'ime do të shumonenë dit e tua, edhe do të shtonenë viet e jetësë s'ate.

<sup>12</sup> Ndë u bëfsh i urtë, do të jesh i urtë për vetëhenë tënde, edhe ndë u bëfsh përqeshës, ti vetëmë do të vuanç.

<sup>13</sup> Gruaja pa mënt, e vrazhëtë, e marrë, edhe që s'di farë-gjëje,

<sup>14</sup> rri ndë derët të shtëpisë saj mbi fron, ndëpër vëndet e lartë të qytetit,

<sup>15</sup> tuke grishur' udhëtarëtë që shkonjënë drejt' udhësë tyre:

<sup>16</sup> "Kush është i marrë, le të këthenetë këtu", edhe ati që s'ka mënt i thotë:

<sup>17</sup> "Ujë' e viedhur' është të ëmbëlë, edhe buk' e mpshehur' është e shishime."

<sup>18</sup> Po ay nuk' e di se atie janë të vdekuritë, edhe ndër të thellat të pisësë (janë) të grishurit' e asaj.

## KREI 10

### Fialët' e urta të Sollomonit.

<sup>1</sup> Bir' i urtë gëzon t'anë, po bir' i marrë është hidhërim i s'ëmësë.

<sup>2</sup> Thesarët' e panomisë s'bënjënë dobi, po dreitëria të shpëton nga vdekëja.

<sup>3</sup> Zoti nukë do të lërë shpirtin' e të dreitit të vdesë nga uria, po pasëjen' e të pabesëvet e përmbys.

<sup>4</sup> Dor' e purtuarë bie vobezi, po dor' e ati që ka kujdes bën të pasurë.

<sup>5</sup> Kush mbëleth ndë verë është i bir' i urtësisë, kush flë ndë të korret (është) i bir' i turpërisë.

<sup>6</sup> Mbi kryet të dreitit (është) bekim, po shtrembëria mbulon golën' e të pabesëvet.

<sup>7</sup> I dreiti përmendetë me bekim, po ëmëri i të pabesëvet kalbetë.

<sup>8</sup> I urti nga zemëra do të marrë porosi, po i marri nga buzëtë do të pengonetë.

<sup>9</sup> Kush ecën dreitë ecën mbarë, po kush shtrembëron nga udhët' e tia do të shquhetë.



- <sup>10</sup> Kush bën me sy, bie të dhëmburë, po i marri nga buzëtë do të pengonetë.
- <sup>11</sup> Gol' e të dreitit (është) gurrë jete, po shtrëmbëria mbulon golën' e të pabesëvet.
- <sup>12</sup> Të mërzituritë bie zënëje, po dashuria mbulon gjithë faletë.
- <sup>13</sup> Ndë buzët të mënçemit gjëndet' urtësia, po shkopi është për kurrizin' e atyre që s'kanë mënt.
- <sup>14</sup> Të urtëtë mbëledhënë mënt, po gola e madhështorit është' afërë humbëjesë.
- <sup>15</sup> Të mirat' e të pasurit (janë) qytet i thurë, (po) prishëja e të vobeqvet është vobezia e atyre.
- <sup>16</sup> Punët' e të dreitit (janë) për jetë, pema e të pabesit (është) për fal.
- <sup>17</sup> Kush ruan mësimin e (gjëndetë) mb' udhë të jetësë, po kush lë qërtimnë silllet' andej e këtej.
- <sup>18</sup> Kush mbulon mërinë (ndënë) buzë të rreme, edhe kush nxier nga gola kallzim, është' i marrë.
- <sup>19</sup> Ndër fialët të shuma nukë shteretë fali, po kush mba buzët' e tia është' i urtë.
- <sup>20</sup> Gluha e të dreitit është' argjënt i sgjedhurë, zemëra e të pabesëvet (është) për mos gjë.
- <sup>21</sup> Buzët' e të dreitit kullosënë shumë vetë, po të marrëtë vdesënë nga të papasuritë mënt.
- <sup>22</sup> Bekimi i Zotit bën të pasurë, edhe nd' atë nukë do të shtonetë hidhërim.
- <sup>23</sup> I pamënçimi e ka të bërëtë keq posi lodrë, po dituria është për njerin' e mënçim.
- <sup>24</sup> Frika e të pabesit do të vinjë mbi atë, po dëshërimi i të dreitëvet do të mbushetë.
- <sup>25</sup> Sikundrë shkon er' e shakullit, kështu do të mos jet' i pabesi, po i dreiti do të qëndronjë ndë jetët të jetësë.
- <sup>26</sup> Posi uthëlla ndër dhëmbët, edhe tymi ndër syt, kështu është purtesësi tek ata që e dërgonjë.
- <sup>27</sup> Frik' e Zotit shton dit, po viet e të pabesëvet do të pakësonenë.
- <sup>28</sup> Shpëresa e të dreitëvet do të jetë gëzim, po shpresa e të pabesëvet do të humbasë.
- <sup>29</sup> Udh' e Zotit është forcë te i mbari, po te punëtorët' e panomisë është humbëje.
- <sup>30</sup> I dreiti nukë do të tundetë ndë jetët të jetëvet, po të pabesëtë nukë do të rrinë ndë dhet.
- <sup>31</sup> Gol' e të dreitit nxier dituri, po gluha gënjeshtare do të këputetë.
- <sup>32</sup> Buzët' e të dreitit njohën' atë që është' e pëlqyerë, po gola e të pabesëvet njeh atë që është' e shtrëmbëtë.

## KREI 11

- <sup>1</sup> Zigareja e rreme është' e ndohtë te Zoti, po zigareja e dreitë është' e pëlqyerë tek ay.
- <sup>2</sup> (Tek) hyn madhështia, hyn edhe turpëria, po urtësia (rri) me të përunjëtit.
- <sup>3</sup> Të tërët' e të dreitëvet do t'u heqë udhën' atyre.
- <sup>4</sup> Pasëja s'bën dobi ndë ditët të zemërimit, po dreitëria shpëton nga vdekëja.
- <sup>5</sup> Dreitëria e njeriut tërë do t'ja bënëj udhënë të dreitë, po i pabesi do të bierë për punë të pabesërisë ti.
- <sup>6</sup> Dreitëria e të dreitëvet do t'i shpëtonjë ata, po faltorëtë do të zihenë ndë të keqet.
- <sup>7</sup> Kur vdes njeriu i pabesë, shpëresa (e ati) baretë, baret' edhe shpresa e të paudhëvet.
- <sup>8</sup> I dreiti shpëton nga shtrëngata, edhe ndë vënt t'ati hyn i pabesi.

<sup>9</sup> Hipokriti prish t'afërmin' e ti me golënë, po të drejtëtë do të shpëtonjënë me anë të urtësisë.

<sup>10</sup> Qyteti gëzonetë kur venë mbarë të drejtëtë, edhe gëzonetë kur prishenë të pabesëtë.

<sup>11</sup> Me bekimin' e të drejtëvet qyteti lartonetë, po me golën' e të pabesëvet prishetë.

<sup>12</sup> Ay që s'ka mënt s'e zë për gjë të afërmin' e ti, po njeriu i urtë pushon.

<sup>13</sup> Ay që përhap fialë sbulon fshehësitatë, po ay që është besëtar ndë shpirt fsheh punënë.

<sup>14</sup> Atie tek nuk' është qivërni, gjëndëja bie, po nga shumica e këshillëset (vien) shpëtim.

<sup>15</sup> Kush bënëtet dorë-zënës për tiatrinë, do të pësonjë keq, po kush mërzit dorë-zënëjenë do të jet' i pafrikëshim.

<sup>16</sup> Gruan' e hieshëme e kanë për nderë, edhe ata që qëndronjënë fitonjënë gjë.

<sup>17</sup> Njeriu i përdëlltershim i bën mirë shpirtit ti, po i papërdëlltershimi shtrëngon trupin' e ti.

<sup>18</sup> I pabesi punon punë të rreme, po ay që mbiell drejtëri do ta ketë pagënë pa frikë.

<sup>19</sup> Sikundrë drejtëria suletë ndë jetët, kështu ay që gjuan të keqenë suletë ndë vdekëjet të ti.

<sup>20</sup> Zotit i vien të ndohtë nga ata që kanë zemërë të shtrembëtë, po ata që ecënjënë dreit' udhësë (janë) të priturë tek ay.

<sup>21</sup> (Ndonëse) dora zë dorënë, i pabesi nukë do të mbesë pa munduarë, po fara e të drejtëvet do të shpëtonjë.

<sup>22</sup> Gruaj' e bukurë pa mënt është si stoli e artë ndë turi të derit.

<sup>23</sup> Dëshërimi i të drejtëvet është vetëm' e mira, po shpëresa e të pabesëvet (është) mëria.

<sup>24</sup> Disa shpërdanjënë, edhe po u tepëronjënë, e disa kurcenjënë fort, po (kanë) nevolë.

<sup>25</sup> Ay shpirt që bën mirë do të mahetë, edhe kush ep ujë, do t'i apën ujë edhe ati.

<sup>26</sup> Atë që mbyll driht do t'e mallëkonjë gjëndëja, po bekim do të jetë mbi kryet t'ati që e shet.

<sup>27</sup> Ay që i bie prapa së mirësë, do të fitonjë hirë, po ay që kërkon të keqenë, do të vinjë mbi atë.

<sup>28</sup> Kush shpëren mbë pasëjet të ti, ky do të bierë, po të drejtëtë do të lulëzonjënë posi bimë.

<sup>29</sup> Kush trubullon shtëpin' e ti do të trashëgonjë erë, po i marri (do t'i bënëtet) shërbëtuat të mënçëmit.

<sup>30</sup> Pem' e të drejtët është dru jete, po ay që fiton shpirtëra është i mënçëm.

<sup>31</sup> Kur të mundonet' i drejti mbi dhet, sa më tepër' i pabesi e faltori.

## KREI 12

<sup>1</sup> Kush do mësimmë, do mëndëjenë, po ay që mërzit qërtimmë është i marrë.

<sup>2</sup> I miri gjen hirë te Zoti, po atë që mendon të liga do t'e dënonjë.

<sup>3</sup> Njeriu nukë do të forconetë me anë të së paudhësë, po rrënja e të drejtëvet do të mbesë e patundurë.

<sup>4</sup> Gruaj' e mirë është kurorë te burri i saj, po ajo që bën turpëri është kalbësirë ndër eshtërat t'ati.

<sup>5</sup> Mendimet' e të drejtëvet janë drejtëri, po këshillet' e të pabesëvet janë kobim.

<sup>6</sup> Fialët' e të pabesëvet bënëjenë pritë për gjak, po gol' e të drejtëvet do t'i shpëtonjë ata.

<sup>7</sup> Të pabesëtë baren' e s'janë më, po shtëpia e të dreitëvet do të mbesë.

<sup>8</sup> Njeriu lavdonetë nga urtësia e ti, po i shtrembëti nga zëmëra do të jetë për të hedhurë poshtë.

<sup>9</sup> Më i mirë është' ay njeri që s'nderonetë, edhe është' i zoti vetiut, se ay që mburretë, edhe s'ka bukë (të hajë).

<sup>10</sup> I dreiti ka kujdes për jetën' e bagëtisë ti, po zemëra e të pabesëvet është' e papërdëllyershime.

<sup>11</sup> Kush punon dhen' e ti do të nginjetë me bukë, po ay që vete pas mëndëjesë të kotëvet s'ka mënt.

<sup>12</sup> I pabesi kërkon t'u dalë zot të këqivet, po rrënja e të dreitit lëshon përsëri.

<sup>13</sup> I pabesi zihetë ndë kurth nga fali i buzëvet, po i dreiti shpëton nga shtrëngimi.

<sup>14</sup> Njeriu do të mbushetë me të mira nga pemët' e golësë (ti), edhe shpagimi i duaret njeriut do të kthenetë prap te ay.

<sup>15</sup> Udh' e të marrit (është') e dreitë ndër sy t' ati, po ay që dëgjon këshille (është') i urtë.

<sup>16</sup> I marri dëften përnjëherë zemërimn' e ti, po i urti mbulon turpëjen' e ti.

<sup>17</sup> Kush flet të vërtetënë rrëfen të dreitënë, po deshmitari i rem (thotë) kobim.

<sup>18</sup> Llomatari (është) posi të prerat' e thikësë, po gola e të urtëvet (është) shërim.

<sup>19</sup> Buzët' e së vërtetësë do të qëndronjënë kurdo, po gluha gënjeshtare (është) vetëmë për një çikëzë herë.

<sup>20</sup> Kobim (është) ndë zemërët t'atyreve që mendonjënë të liga, po te ata që këshillonjënë paqtim (është) gëzim.

<sup>21</sup> Të dreitit nukë do t'i bënëti ndonjë dëm, po të pabesëtë do të mbushenë me të këqia.

<sup>22</sup> Zotit i vien të ndohtë nga buzëtë gënjeshtare, po ata që bënëti të vërtetënë (janë) të priturë tek ay.

<sup>23</sup> Njeriu i urtë mbulon mënt, po zemëra e të marrëvet leçit marrëzi.

<sup>24</sup> Dora e punëtorëvet do t'urdhëronjë, po purtesësitë do të jenë ndën' urdhërë.

<sup>25</sup> Hidhërimi ndë zemërët të njeriut ja përunj atë, po fial' e mirë ja gëzon atë.

<sup>26</sup> I dreiti ja shkon më tepërë t'afërmit ti, po udh' e të pabesëvet i gënjen ata.

<sup>27</sup> Kush purton nukë zë gjahun' e ti, po gjëja e njeriut kujdesshëm (është) shumë e vëlyerë.

<sup>28</sup> Nd' udhët të dreitërisë (është) jetë, edhe udh' e asaj nukë (të nxier) ndë vdekëjet.

## KREI 13

<sup>1</sup> Dial' i urtë (dëgjon) mësimin' e t'et, po përqeshësi nukë dëgjon qërtim.

<sup>2</sup> Njeriu do të hajë të mira nga pemët' e golësë ti, po shpirti i të paudhëvet është shtrëmbëri.

<sup>3</sup> Kush ruan golën' e ti, ruan jetën' e ti, po ay që është golë-sbrazëtë do të humbasë.

<sup>4</sup> Shpirti ati që purton, dëshëron e s'ka, po shpirti i atyre që punonjënë do të nginjetë.

<sup>5</sup> I dreiti mërzit fialën' e rreme, po i pabesi është' i qelbur' e i turpëruarë.

<sup>6</sup> Dreitëria ruan atë që është' i mbarë mb' udhët, po faltorin' e prish pabesëria.

<sup>7</sup> Ka (njeri) që bën vetëhenë për të pasurë, e s'ka farë-gjëje, (e ka njeri) që bën vetëhenë për të vobek, e (ka) shumë gjë.

<sup>8</sup> Shpërblimi i shpirtit njeriut (është) gjëj' e ati, po i vobegu nukë dëgjon qërtim.

<sup>9</sup> Drita e të dreitëvet ndrit, po kandili i të pabesëvet do të shuhetë.

<sup>10</sup> Vetëmë nga madhështia del zënëja, po urtësia është bashkë me ata që marrënë këshille.

<sup>11</sup> Gjëja (fituarë) nga kotësira do të pakësonetë, po ay që mbëleth me dorën' (e ti) do të madhonetë.

<sup>12</sup> Ajo shpëresë që mënohetë likshton zemrënë, po kur vien ajo që ka mall për atë, (është) dru jete.

<sup>13</sup> Ay që heth tej fialënë do të humbasë, po ay që i ka frikë porosisë, ky do të shpaguhetë.

<sup>14</sup> Nomi i të urtit është gurrë jete, që mërgon nga kurthet' e vdekëjesë.

<sup>15</sup> Urtësia e mirë ep hirë, po udh' e faltorëvet (të shpie) ndë humbëjet.

<sup>16</sup> Ç' do njeri i urtë punon me mënt, po i marri sbulon marrëzinë.

<sup>17</sup> I laimi i keq bie ndë të keqe, po laimësi i besësë (është) shërim.

<sup>18</sup> Vobezi e turpëri (do të ketë) ay që heth tej mësimnë, po ay që ruan qërtimnë do të nderonetë.

<sup>19</sup> Kur mbushetë dëshërimi kënaq shpirtinë, po të marrëvet u vien të ndohtë të prirenë nga e keqeja.

<sup>20</sup> Kush ecën me të urtëtë do të jet' i urtë, po shoku i të marrëvet do të thyenjë qafënë.

<sup>21</sup> E keqeja ndiek faltorë, po të dreitëvet do t'u epet' e mira.

<sup>22</sup> I miri u lë trashëgim bijet të bijet, po gjëja e faltorit mbëlidhetë për të dreitinë.

<sup>23</sup> Ara e të vobeqvet ep shumë ushqim, po disa humbasënë, sepse nukë shquanjënë të dreitënë.

<sup>24</sup> Kush kërcen shkopin' e ti, mërzit të birrë, po ay që e do, e mundon me kohë.

<sup>25</sup> I dreiti ha gjersa t'i ngingjetë shpirti, po barku i të pabesëvet do të shteretë.

## KREI 14

<sup>1</sup> Grat' e urta ndërtonjënë shtëpin' e tyre, po e marra e rëmon atë me duart' e saja.

<sup>2</sup> Ay që ecën ndë të dreitët të ti i ka frikë Zotit, po i shtrembëti nd' udhët të ti s'e zë për gjë atë.

<sup>3</sup> Ndë golët të marrit (është) shkopi i madhështisë, po buzët' e të urtëvet do t'i ruanjën' ata.

<sup>4</sup> Tek s'ka qe, koshtareja (është) e sbrazëtë, po të plotët' e drithit (është) prej fuqisë kaut.

<sup>5</sup> Dëshmitari i dreitë nukë do të gënjenjë, po dëshmitari i rrem derth gënjeshtira.

<sup>6</sup> Përqeshësi kërkon dituri, edhe nukë gjën, po për të urtinë (është) i kollajtë mësimi.

<sup>7</sup> Del përpara njeriut pa mënt, edhe nukë do të gjënjç buzë urtësie.

<sup>8</sup> Dituria e të urtit (është) të njohë udhën' e ti, po marrëzia e të marrëvet (është) t'ecurë të kotë.

<sup>9</sup> Të marrëtë qeshënë ndë panomit, po ndë mest të dreitëvet (është) hirë.

<sup>10</sup> Zemër' (e njeriut) njeh hidhësrën' e shpirtit ati, edhe i huajë nukë merr pjesë prej gëzimiti ati.

<sup>11</sup> Shtëpia e të pabesëvet do të humbasë, po tend' e të dreitëvet do të lulëzonjë.

<sup>12</sup> Ka udhë (që i duket') e dreitë njeriut, po fundi asaj të bie ndë vdekëje.

<sup>13</sup> Po edhe kur qesh dhëmp zemëra, edhe fundi i gëzimit është hidhërim.

<sup>14</sup> Ay që ka zemërë të prishurë do të mbushetë nga udhët' e tia, po njeriu i mirë prej vetëhesë ti.

<sup>15</sup> I mituri beson ç' do fialë, po i urti u mba vesh çapavet tia.

<sup>16</sup> I urti ka frikë, e ikën nga e keqeja, po i marri shkon përpara, edhe ashpëronetë.

<sup>17</sup> Ay që zemëronetë shpejtë punon pa mendim, po njeriu zemërëkeq është i mërziurë.

<sup>18</sup> Të marrëtë trashëgonjënë marrëzi, po të urtëtë kurorëzononë me urtësi.

- <sup>19</sup> Të këqitë bienë ndë gjunj përpara të mirëvet, edhe të pabesëtë ndër dyert të dreitëvet.
- <sup>20</sup> I vobegu mërztet' edhe nga fëqinja e ti, po i pasuri ka shumë miq.
- <sup>21</sup> Kush heth poshtë të afërmin' e ti fëlen, po kush përdëllen të vobeqtë është i lumurë.
- <sup>22</sup> A s'gënjehen' ata që mendonjënë të ligënen? Po përdëllim e dreitëri do të jetë ndër ata që mendonjënë të mirënë.
- <sup>23</sup> Mbë ç'do mundim (është) fitim, po lllomatia e buzëvet bie vetëmë vobezi.
- <sup>24</sup> Gjëja e të urtëvet (është) kurorë ndër ata, po gjëja e të marrëve (është) marrëzi.
- <sup>25</sup> Deshmitari i dreitë shpëton shpirtëra, po i rremi derth gënjeshtër.
- <sup>26</sup> Ndë frikët të Zotit (është) shpëres' e fortë, edhe ndër djemt t'ati do të jetë mpshtetëje.
- <sup>27</sup> Frik' e Zotit (është) gurrë jete, që mërgon nga kurthet' e vdekëjesë.
- <sup>28</sup> Lavdia e mbëretit (është) ndë shumicët të gjëndëjesë, po prishëja e ati që zotëron (është) ndë pakicët të gjëndëjesë.
- <sup>29</sup> Zëmërë-gjëri (ka) urtësi të madhe, po zëmërë-ngushti shton marrëzinë.
- <sup>30</sup> Zëmër' e shëndoshë (është) jet' e kurmit, po cmiri (është) kalbësira e eshtëaravet.
- <sup>31</sup> Kush shtrëngon të vobegunë, (shpërndëron) Bërësin' e ati, po kush nderon atë, përdëllen të vobegunë.
- <sup>32</sup> I pabesi tmeronetë ndë pabesëri të ti, po i dreiti ka shpëresë ndë vdekëjet të ti.
- <sup>33</sup> Ndë zëmërët të mënçëmit prëhet' urtësi, po ndë mest të marrëvet shpërfaqetë.
- <sup>34</sup> Dreitëria larton komp, po fali (është) turpëri gjëndëjesh.
- <sup>35</sup> Mbëreti ka mbë sy të mirë shërbëtorin' e urtë, po zemërimi i ati (është) mb' atë që bën turpëri.

## KREI 15

- <sup>1</sup> Të përgjegjurit' e ëmbëlë cbut zemërimnë, po fial' e hidhurë dhes zemërimnë.
- <sup>2</sup> Gluh' e të urtëvet sbukuron mëndjënë, po gol' e të marrëvet gromësin marrëzi.
- <sup>3</sup> Syt' e Zotit (janë) mbë ç'do vënt tuke shikuarë të këqi e të mirë.
- <sup>4</sup> Gluh' e shëndoshë (është) dru jete, po e shtrëmbëta (është) të thyerë frymë.
- <sup>5</sup> I marri heth poshtë mësimn' e t'et, po ay që ruan qërtim është i urtë.
- <sup>6</sup> Ndë shtëpi të dreitit (janë) shumë thesarë, po ndë pronjë të pabesit (është) të shpërndarë.
- <sup>7</sup> Buzët e të urtëvet përndanjënë mënt, po zemëra e të marrëvet nuk' (është) kështu.
- <sup>8</sup> Kurbani i të pabesëvet (është) i ndyrë te Zoti, po lutëja e të dreitëvet është e priturë te ay.
- <sup>9</sup> Udha e të pabesit (është) e ndohëtë te Zoti, po do atë që gjuan dreitërinë.
- <sup>10</sup> Ay që ka lën' udhënë, nukë pëlqen mësimnë, ay që mërztit qërtimnë, do të vdesë.
- <sup>11</sup> Hadhi edhe humbëja (janë) përpara Zotit, sa më tepërë zemërat' e të bijet njerëzet?
- <sup>12</sup> Përqeshësi nukë do atë që e qërtion, as nukë do të vejë te të urtëtë.
- <sup>13</sup> Zemër' e gëzuarë sbut faqenë, po nga hidhërimi i zemëresë shtrëngonetë fryma.
- <sup>14</sup> Zemëra e të urtit kërkon mënt, po gola e të marrëvet kullot marrëzi.
- <sup>15</sup> Gjithë dit e të shtrënguarit (janë) të këqia, po kush ka zemërenë të gëzuarë ka gosti kurdo.
- <sup>16</sup> Më mirë e paka me frikë të Zotit, se shumë thesarë e trubullim ndër ata.

- 17 Më mirë një gosti lakrash me dashuri, se një viç i ushqyerë me mërzitëje.  
18 Njeriu zemërak dhes luftëra, po zëmërë-gjëri pushon zënëje.  
19 Udh' e purtesësit (është) thurë me ferra, po udh' e të dreitëvet (është) e sheshuarë.  
20 Bir' i urtë gëzon tanë, po njeriu i marrë përqesh t'ëmënë.  
21 Marrëzia (është) gëzim te ay që s'ka mënt, po njeriu i mënçim ecën dreitë.  
22 Tek s'ka këshillë, mendimetë dalënë të kotë, po tek janë shumë këshillës forconenë.  
23 Lum ay njeri për të përgjegjurit' e golësë ti, edhe fiala ndë kohët sa e mirë (është)!  
24 Udh' e jetësë te i mënçëmi (është) lart, që të prapsetë nga hadhi poshtë.  
25 Zoti prish shtëpin' e madhështorëvet, po forcon kufin' e së vesë.  
26 Mentimet' e të ligut (janë) të ndohëtë te Zoti, po fialët' e të këthiellëvet (janë) të pëlqyera.  
27 Mitë-marrësi trubullon shtëpin' e ti, po kush mërzit mitatë do të rronjë.  
28 Zemëra e të dreitit mendonetë, pra përgjegjetë, po gola e të paudhëvet gromësin të këqia.  
29 Zoti (është) lark nga të paudhëtë, po dëgjon lutëjen' e të dreitëvet.  
30 Drit' e syvet gëzon zemërënë, edhe zëri i mirë man eshtëratë.  
31 Ay vesh që dëgjon qërtimin' e jetësë, gjëndëtë ndër të urtët.  
32 Kush heth tej mësimnë, mërzit shpirtin' e ti, po kush dëgjon qërtimnë, fiton mëntëje.  
33 Frik' e Zotit (është) mësim diturie, edhe të përunjuritë shkon përpara lavdisë.

## KREI 16

- 1 Të bërëtë gati të zemërësë njeriut, edhe të përgjegjurit' e gluhësë, është prej Zotit.  
2 Gjith' udhët' e njeriut dukenë të dreita ndër syt t'ati, po Zoti peshon frymatë.  
3 Varë punët' e tua te Zoti, edhe këshillimet' e tu do të forconenë.  
4 Zoti bëri të gjitha për vetëhen' e ti, po edhe të paudhinë për ditën' e keqe.  
5 Zotit i vien të ndohëtë prej ç'do madhështori ndë zemërët, ndonëse dora rrok dorënë, po ay nukë do të jet' i pafal.  
6 Panomia qëronetë me anë të hirit të së vërtetësë, edhe njerëzitë prapsenë nga e keqja me anë të frikësë Zotit.  
7 Kur i pëlqenjënë Zotit udhët' e njeriut, paqton edhe arëmiqt' e ati bashkë me atë.  
8 Më mirë pak e me të dreitë, se shumë pronje e me të paudhë.  
9 Zemëra e njeriut mendon udhën' e ati, po Zoti drejton çapat' e ati.  
10 Fialë Perëndie është ndër buzët të mbëretit, gola e ati nukë fëlen ndër gjyqt.  
11 Pësja e dreitë edhe zigarea janë të Zotit, gjithë peshat' e thesit janë pun' e ati.  
12 Mbëretëret u vien të ndohëtë të punonjëne paudhë, sepse froni forconetë nga dreitëria.  
13 Buzët' e dreita janë të pëlqyera ndër mbëretërit, edhe duan' atë që flet dreitë.  
14 Zemërimi i mbëretit është zë-dhënësi i vdekëjesë, po njeriu i urtë e sbut atë.  
15 Ndë dritët të faqesë mbëretit është jetë, edhe të mirët' e ati është posi re shiu të ri.  
16 Sa më mirë është të fitonjë njeriu dituri, se ar! Edhe më mirë të fitonjë urtësi, se argjënt!  
17 Udh' e të dreitëvet është të prapsenë nga e keqja; kush ruan udhën' e ti, ruan shpirtin' e ti.

<sup>18</sup> Madhështia shkon përpara prishëjesë, edhe të mbajturit' e shpirtit mbë të math shkon përpara rënëjesë.

<sup>19</sup> Më mirë të jetë ndonjë krye-unjurë bashkë me të përunjuritë, se të ndanjë plaçëka bashkë me madhështorët.

<sup>20</sup> Kush është i mënçëm mbë punët, do të gjenjë mirë, edhe kush shpëren mbë Zotinë është i lumurë.

<sup>21</sup> Ay që është i mënçëm ndë zemërët do të kluhet' i urtë, edhe ëmbëlsira e buzëvet shton mësim.

<sup>22</sup> Urtësia është gurrë jete te ay që e ka atë, po mësimi i të marrëvet është marrëzi.

<sup>23</sup> Zemëra e të urtit urtëson golën' e ati, edhe shton mësim ndër buzët t'ati.

<sup>24</sup> Fialët' e pëlqyera (janë) hojë mialte, ëmbëlsirë ndë shpirt, e shërim ndër eshtërat.

<sup>25</sup> Ka udhë që i duketë njeriut e dreitë, po fundi i asaj është udhë vdekëje.

<sup>26</sup> Kush punon, punon për vetëhen' e ti, sepse gola e ati e shtrëngon atë.

<sup>27</sup> Njeriu i lik rëmon të keqe, edhe ndër buzët t'ati është posi zjarr që diek.

<sup>28</sup> Njeriu i shtrembëtë mbiell zënëje, edhe pështëllinjësi ndan më të dashuritë miq.

<sup>29</sup> Njeriu shtrëngatës gënjen të afërmin' e ti, edhe e bie mb' udhët që s'është' e mirë;

<sup>30</sup> kur mbyll syt' e ti, mendonetë të gjenjë (punë) të shtrembëta, tuke kafshuarë buzët' e tia bën të keqenë.

<sup>31</sup> Flokët' e sbardhura janë kurorë lavdie që gjendenë mb' udhë të dreitërisë.

<sup>32</sup> Zëmërë-gjëri (është) më i mirë se i forti; edhe ay që përmba shpirtin' e ti, se ay që prish një qytet.

<sup>33</sup> Shorta hidhetë ndë kuletët, po gjithë gjyqi i asaj (është) nga Zoti.

## KREI 17

<sup>1</sup> Më mirë bukë thatë, e paqtim bashkë me atë, se plot shtëpinë me kurbane bashkë me zënëje.

<sup>2</sup> Shërbëtori i urtë do t'urdhëronjë birin' e turpëjesë, edhe do të ndanjë trashëgimnë bashkë ndë mest të vëllezëret.

<sup>3</sup> Sqyreja që tret shprovon argjëdinë, furra arinë, po Zoti zemëratë.

<sup>4</sup> Keq-bërësi dëgjon buzët' e paudha, gënjeshtari i mba vesh gluhësë ligë.

<sup>5</sup> Kush përqesh të vobegunë, shan Bërësin' e ati; kush gëzonetë për të ligat, nukë do të mbesë pa munduarë.

<sup>6</sup> Kurora e pleqvet janë djemt' e djemvet, edhe lavdia e djemvet janë përint' e atyre.

<sup>7</sup> Buzë të larta nuk' i vëlenjënë të marrit; shumë më pak buzë të rreme (nuk') i vëlenjënë zotërisë.

<sup>8</sup> Mita (është posi) gur i paçimuarë ndër sy të mitë-marrësit; atie tek duketë këjo, mbaron punë.

<sup>9</sup> Kush fsheh falinë, kërkon miqësi, po kush e merr ndëpër golë punënë, ndan më të dashuritë miq.

<sup>10</sup> Qërtimi rreh të urtinë më tepërë, se një qint frushkulla të marrinë.

<sup>11</sup> I ligu kërkon vetëmë trubullime, përandaj do të dërgonetë zë-dhënës i keq kundrë ati.

<sup>12</sup> Le të piqetë me njerinë harusha që i kanë marrë këlyshhtë, e mos i marri ndë marrëzi të ti.

<sup>13</sup> Kush shpaganë të keqe, ndë vënt të së mirësë, e keqeja nukë do të ikënjë prej shtëpis' ati.

<sup>14</sup> Kush zë të bënë qartë, (është posi) ay që çthur ujëra, përandaj pusho nga qarta përpara se të dhizetë.

<sup>15</sup> Kush nxier pa fal të paudhinë, edhe dënon të dreitinë, të dy janë të ndohëtë te Zoti.

<sup>16</sup> Ç'vëlen argjëndi ndë dorët të marrit, që të blenjë dituri, kur ay s'ka mënt?

<sup>17</sup> Miku të do kurdo, po vëllaj lint ndë kohë të nevolësë.

<sup>18</sup> Njeriu që s'ka mënt zë dorënë, (edhe) zihetë dorë-zënës për mikun' e ti.

<sup>19</sup> Kush do qarta, do fale; kush larton fort derën' e ti, kërkon prishëje.

<sup>20</sup> Kush ka zemërë të shtrëmbëtë, nukë gjen mirë, edhe kush ka gluhë të shtrëmbëtë bie ndë të keqe.

<sup>21</sup> Kush piell të marrë, e bën për helmimin' e ti; i ati i të marrit s'ka gëzim.

<sup>22</sup> Zemër' e gëzuarë të bën mirë (posi) miekësi, po shpirti i thyerë thanë eshtëratë.

<sup>23</sup> I paudhi merr dhuratë nga gjiri, për të shtrëmbëruar' udhët' e gjyqit.

<sup>24</sup> Ndë faqet të urtit (është) dituri, po syt' e të marrit shohënë mb' anë të dheut.

<sup>25</sup> Bir' i marrë (është) helmim te i ati, edhe hidhërim te ajo që e ka piellë.

<sup>26</sup> Nuk' (është) kurrë mirë t'i apënë mundim të drestit, (a) t'u bienë të parëvet për dreitërin' e atyre.

<sup>27</sup> Ay që mba fialënë (është) i mënçëm, zemërë-gjëri është' i urtë.

<sup>28</sup> Edhe ay i marri, kur s'flet me golë, numëronetë për i urtë; edhe ay që mbyll golën' e ti është' i mënçim.

## KREI 18

<sup>1</sup> Kush pëlqen mëndejen' e ti, kërkon pas dëshërimit ti, (edhe) i rri kundrë ç'do gjëje që është' e dreitë.

<sup>2</sup> Të marrit nuk' i pëlqen urtësia, po ç'mendon zemër' e ati.

<sup>3</sup> Kur vien i paudhi, vien edhe të përqeshuritë; edhe bashkë me të sharëtë vien edhe turpëria.

<sup>4</sup> Fialët' e golësë njeriu (janë) ujëra të thella, edhe gurra e diturisë (është posi) përrua që rrieth.

<sup>5</sup> Nuk' është mirë t'i mbanjë krahë njeriu të paudhit, për të pëmbysurë të dreitënë ndë gjyqit.

<sup>6</sup> Buzët' e të marrit hynjënë ndë zënëje, edhe gola e ati gërshet shuplaka.

<sup>7</sup> Gola e të marrit (është) prishëja e ati, edhe buzët' e ati (janë) dhokan ndë shpirt t'ati.

<sup>8</sup> Fialët' e pështëllonjësit kapërcehen' ëmbëlë, edhe sbresënë gjer ndë zorrët të barkut.

<sup>9</sup> Ay që purton të punonjë me të vërtetë (është) i vëllaj i plank-prishësit.

<sup>10</sup> Emëri i Zotit (është) pirgu i fortë; i dreiti kur mbulon kryetë ndënë atë, gjëndetë ndë siguri.

<sup>11</sup> Të miratë te i pasuri (janë) qytet i fortë, edhe i pandeh për mur të lartë.

<sup>12</sup> Përpara prishëjesë lartonetë zemëra e njeriut; edhe të përunjuritë shkon përpara lavdisë.

<sup>13</sup> Të përgjegjetë (ndonjë) pa dëgjuarë, është marrëzi e turpëri për atë.

<sup>14</sup> Frym' e njeriut do të forconjë dobësirën' e ati, po frymën' e shtrënguarë kush munt ta duronjë?

<sup>15</sup> Zemëra e të urtit fiton të kupëtuarë, edhe veshi i të dituret kërkon mënt.

<sup>16</sup> Dhurata e njeriut hap vënt për atë, edhe e bie përpara të mëdhenjvet.

<sup>17</sup> Ay që flet më përpara ndë gjyq të ti (duket') i dreitë, po vien kundra-gjyqësi i ati edhe e qërton atë.

<sup>18</sup> Shorta pushon qartatë edhe e këput fialënë ndë mest të fortëvet.



<sup>19</sup> Kur zihetë vëllaj (është më keq se të bierë ndë) dorë një qytet i fortë, edhe zënëjet' e atyre (janë) posi lloze pingu.

<sup>20</sup> Nga pemët' e golësë njeriut do të nginjetë barku i ati; nga prodhi i buzëvet ati do të mbushetë.

<sup>21</sup> Vdekëja e jeta varenë ndë gluhët; edhe ata që duan' atë, do të hanë pemët' e asaj.

<sup>22</sup> Kush gjeti grua, gjeti gjë të mirë, edhe fitoi hirë nga Zoti.

<sup>23</sup> I vobegu flet me të lutura, po i pasuri përgjigjetë me të vrazhëtë.

<sup>24</sup> Ay njeri (që ka) miq, gjan të shkonjë miqësisht, edhe ka mik më të dashurë se vëllanë.

## KREI 19

<sup>1</sup> Më i mirë është i vobegu që ecën ndë të tërët të ti, se (i pasuri) që shtrëmbëron buzët' e tia, edhe është pa mënt.

<sup>2</sup> Shpirt pa mënt me të vërtetë nuk' (është) gjë e mirë; edhe kush nxiton këmbëtë, pengonetë.

<sup>3</sup> Marrëzia e njeriut shtrëmbëron udhën' e ati, edhe zemëra e ati mpeshon mbë Zotinë.

<sup>4</sup> Gjëja shton shumë miq, po nga i vobegu heq dorë (edhe) miku i ti.

<sup>5</sup> Deshmitari i rrem nukë do të mbetetë pamunduarë, edhe kush flet gënjeshtro nukë do të shpëtonjë.

<sup>6</sup> Shumë (vetë) përkëdhelënë faqen' e të parit, edhe kushdo është miku i ati njeriu që ep.

<sup>7</sup> Të vobegun' e mërzitnjënë gjithë të vëllezëritë; sa më tepërë do të mërgonenë nga ay miqt' e ati? Ay vete pas tuke klithurë, po ata nukë (përgjigjenë).

<sup>8</sup> Kush fiton dituri do shpirtin' e ti; kush ruan urtësi do të gjenjë mirë.

<sup>9</sup> Deshmitari i rrem nukë do të mbetetë pa munduarë; edhe kush flet gënjeshtro do të vdiuretë.

<sup>10</sup> Kënaqëja nuk' i vëlen të marrit; shumë më tepërë shërbëtorit, të urdhëronjë zotërinë.

<sup>11</sup> Urtësia e njeriut përmbëleth zemërimin' e ati, edhe është lavdi për atë të mos shohë falinë.

<sup>12</sup> Zemërimi i mbëretit është posi ulërimë leoni, po miqësia e ati (është) posi vesa mbi barinë.

<sup>13</sup> Bir' i marrë (është) prishëja e t'et; edhe të zënat' e gruasë (janë) si pika që s'pushon.

<sup>14</sup> Shtëpi e gjë trashëgonenë nga atëritë, po gruaja e urtë nga Zoti.

<sup>15</sup> Purtesa heth (njerinë) ndë gjumë të rëndë, edhe shpirti i papunë do të ketë uri.

<sup>16</sup> Kush ruan porosinë, ruan shpirtin' e ti, po ay që përmbys udhët' e tia do të vdiuretë.

<sup>17</sup> Kush përdëllen të vobegunë huan Zotinë, edhe do t'i shpaguehetë.

<sup>18</sup> Mundo t'ët-bir gjer sa është shpëresë, po le të mos të dhizetë shpirti, gjersa ta vraç atë.

<sup>19</sup> Zemëraku do munduarë, sepse edhe ndë e lërofsh (atë), përsëri do t'e bënjë (atë punë).

<sup>20</sup> Dëgjo këshille e prit mësim, që të bënesh i diturë më ndë funt.

<sup>21</sup> Shumë mendime janë ndë zemëretë të njeriut, po këshillëja e Zotit do të qëndronjë vetëmë.

<sup>22</sup> Nderi i njeriut (është) të mirët' e ati; edhe i vobegu (është) më i mirë se gënjeshtari.

<sup>23</sup> Frik' e Zotit bie jetë, edhe do të bierë (të flerë) nginjurë, ndonjë e ligë nukë do t'e gjenjë.

<sup>24</sup> Ay që purton ngjyen dorën' e ti ndë kupët, edhe nukë do ta kthenjë as ndë golët të ti.

<sup>25</sup> Ndë frushkullofsh përqeshësinë, i mituri do t'e ketë ndër mënt, edhe ndë qërtofsh t'urtinë, do të xënjë mënt.

<sup>26</sup> Kush shpërnderon tanë, e shtyn t'ëmënë, (është) një bir që bën turpëri e të sharë.

<sup>27</sup> Pusho, o biri im, së dëgjuari mësim që të praps nga fialët' e të kupëtuarit.

<sup>28</sup> Deshmitar' i paudhë përqesh të dreitinë, edhe gola e të paudhëvet përpin paudhëri.

<sup>29</sup> Gjyqe bënëni gati për përqeshësit, shqepë për kurrizin' e të marrëvet.

## KREI 20

<sup>1</sup> Vera është përqeshëse, edhe të pirët' e fortë bie qarta, edhe kush gënjetet nga këto, nuk' (është) i urtë.

<sup>2</sup> Kanosia e mbëretit është ulurimë leoni: kush nxen atë, fëlen kundër jetësë ti.

<sup>3</sup> Nderi i njeriu është të pushonjë nga qarta, po ç'do i marrë ngatërronetë (ndë këtë).

<sup>4</sup> Kush purton nukë do të laronjë nga pun' e dimërit, (përandaj) do të kërkonjë ndë verë, po nukë (do të gjenjë).

<sup>5</sup> Këshilleja ndë zemëret të njeriu (është posi) ujëra të thella, po njeriu i mëncim do t'e nxierë atë.

<sup>6</sup> Shumë njerës leçisënë gjithësecili të mirën' e ti, po kush do të gjenjë njeri besëtar?

<sup>7</sup> I dreiti ecën ndë të tërët të ti, edhe të bijtë (janë) të lumurë pas ati.

<sup>8</sup> Mbëreti kur rri mbë fron të gjyqit, përndan ç'do të keqe me syt e ti.

<sup>9</sup> Kush munt të thotë: Qërova zemërenë t'ime, jam i qëruarë nga falet' e mi?

<sup>10</sup> Gjithë ç'farë zigjesh, gjithë ç'farë masash, (janë) të dy palëtë të ndohëta te Zoti.

<sup>11</sup> Edhe dialli vetë njihetë nga punët' e tia, ndë janë punët' e ati të qëruara, edhe ndë janë të dreita.

<sup>12</sup> Veshi dëgjjon, e syri sheh, po Zoti i ka bërë të dy.

<sup>13</sup> Mos duaj gjumënë, që të mos bënësh i vobek; hap syt' e tu, edhe do të nginjesh me bukë.

<sup>14</sup> E keqe, e keqe, thot' ay që blen, po si të ikënjë mburretë.

<sup>15</sup> Ka ar, edhe shumicë margaritarësh, po gol' e urtë (është) e paçimuarë.

<sup>16</sup> Merr rrobën' e dorë-dhënësit (për të huajë), edhe për penk nga ay, (si për) plaçka të huaja.

<sup>17</sup> Buk' e gënjeshtërsë (është) e ëmblë te njeriu, po pastaj gol' e ati do të mbushetë me haliqë.

<sup>18</sup> Mendimetë forconenë me anë të këshillesë, edhe si të mendonesh mirë bën luftë.

<sup>19</sup> Ay që silletë mb'-at'-anë e mbë-kët'-anë e përndan fialë, sbulon të fshehuratë, përandaj mos u përzie bashkë me atë që sgjëron buzët' e tia.

<sup>20</sup> Kandilej' e ati që shan tanë e t'ëmënë do të shuhetë nd' errësirë të thellë.

<sup>21</sup> Ay trashëgim që është fituarë shpejt ndë kryet të herësë, nukë bekonetë ndë funt.

<sup>22</sup> Mos thuash: Do të shpaganj të keqenë, prit Zotinë, edhe do të të shpëtonjë.

<sup>23</sup> Gjithë ç'farë zigjesh (janë) të ndohëta te Zoti, edhe kupat' e zigjit rrem nukë (janë) të mira.

- <sup>24</sup> Çapat' e njeriut (ndreqenë) prej Zotit, qysh do ta njihje pra njeriu udhën' e ti?  
<sup>25</sup> Është dhokan për atë njeri që nxitonetë të flasë për gjë të shënjtëruarë, edhe të mendonetë pas së faluravet.  
<sup>26</sup> Mbëreti i urtë heth të paudhëtë (posi kashtën' e grurit), edhe surrullat rrotovilenë mbi ata.  
<sup>27</sup> Kandilëj' e Zotit (është) frym' e njeriut, që shikon gjithë të thellat' e zëmëresë.  
<sup>28</sup> Përdëllimi edhe e dreita ruanjënë mbëretinë, edhe froni i ati forconetë prej përdëllimit.  
<sup>29</sup> Mburrimi i të rivet (është) fuqia e atyreve; edhe lavdia e pleqet (janë) qimet' e bardha.  
<sup>30</sup> Plagët' e zeza të rrahurit (janë) miekësi tek i ligu; edhe të rrahuratë (qëronjënë) të thellat' e zëmëresë.

## KREI 21

- <sup>1</sup> Zemëra e mbëretit (është) ndë dorët të Zotit posi rriedhë ujërash: ku të dojë, këthen atë.  
<sup>2</sup> Gjith' udhët' e njeriut i dukenë të dreita ndër syt t'ati, po Zoti peshon zemëratë.  
<sup>3</sup> Të bënë ndonjë dreitëri e gjyq, është më e pëlqyer te Zoti se kurhani.  
<sup>4</sup> Syri i keq, e zemëra madhështore, e drit' e të pabesëvet, (janë) fale.  
<sup>5</sup> Mendimet' e kujdestarit (janë) vetëmë mbë të plotë, po ç'do madhështori (janë) me të vërtetë për nevolë.  
<sup>6</sup> Të fituarët' e gjësë me gluhë të rreme (është) të kotë të paqëndruarë ndër ata që kërkonjënë vdekëje.  
<sup>7</sup> Rrëmbesat' e të pabesëvet do t'i humbasnjën ata, sepse s'duanë të bënëjënë të dreitënë.  
<sup>8</sup> Udh' e njeriut prishurë (është) e shtrëmbëtë, po pun' e të qëruarit (është) e dreitë.  
<sup>9</sup> Më mirë të rrijë (njeriu) ndë çipt të dhomësë, se ndë shtëpi të gjërë bashkë me grua që do zënëje.  
<sup>10</sup> Shpirti i të paudhit dëshëron të ligënë, i afërmi nukë gjën hirë ndër syt t'ati.  
<sup>11</sup> Kur mundonetë përqeshësi, i mituri bënëtet më i urtë; edhe i urti kur mësonetë, xë mënt.  
<sup>12</sup> I dreiti mendonetë për shtëpin' e të paudhit, (po) të paudhëtë rrëzonenë ndë të keqet.  
<sup>13</sup> Kush zë veshët' e ti, kur klëthet i vobegu, do të klëthasë edhe ay, po nukë do të dëgjonetë.  
<sup>14</sup> Dhurat' e fshehurë sbut zemëratë, edhe dhurëtia ndë gji (sbut) mëri të fortë.  
<sup>15</sup> (Është) gëzim për të dreitinë të bënëj gjyq, po për punëtorët' e së paudhësë (është) prishëje.  
<sup>16</sup> Njeriu që ka humbur' udhën' e urtësisë ka për të ndenjurë ndë mbëledhëjet të vrarëvet.  
<sup>17</sup> Kush do dëshërimnë (do të bënet') i vobek; kush do verë e mirrë nukë do të bënet' i pasurë.  
<sup>18</sup> I pabesi (do të jetë) shkëmbes' e të dreitit, edhe faltori (do të jetë) shpërblim i të dreitëvet.  
<sup>19</sup> Më mirë të rri (njeriu) ndë dhe të shkretë, se bashkë me grua qartatore e zemërake.  
<sup>20</sup> Thesar i paçimuarë edhe mirra (gjëndenë) ndë shtëpi të urtit, po njeriu i marrë i prish ato.  
<sup>21</sup> Kush gjuan dreitëri e përdëllim do të gjënjë jetë, e dreitëri, e lavdi.  
<sup>22</sup> I urti rrëzon qytetin' e të fortëvet, edhe heth poshtë murin' e shpëresës' ati.  
<sup>23</sup> Kush ruan golën' e ti e gluhën' e ti, ruan shpirtin' e ti nga shtrëngimetë.

<sup>24</sup> Madhështuar e perqeshës krye-lartë kluhet' ay që punon me zemërim madhështie.

<sup>25</sup> Dëshërimetë vrasën' atë që purton, sepse duart' e ati nukë duanë të punonjëne;

<sup>26</sup> gjithë ditënë dëshëron dëshërime, po i dreiti ep edhe s'kurcen.

<sup>27</sup> Kurbani i të pabesëvet (është) i andohtë; shumë më tepërë (kur) e bien' atë me dreqësi.

<sup>28</sup> Dëshmitari i rrem do të vdiqetë, po ay njeri që bindetë do të flasë përherë.

<sup>29</sup> Njeriu i paudhë ashpëron faqen' e ti, po i dreiti drejton udhët' e tia.

<sup>30</sup> S'ka dituri, as urtësi, as këshille, kundrë Zotit.

<sup>31</sup> Kali bënëte gati për ditën' e luftësë, po shpëtimi është prej Zotit.

## KREI 22

<sup>1</sup> Më mirë (të kesh) emërë të mirë se shumë gjë, hirë të mirë, se argjënt e ar.

<sup>2</sup> I pasur' e i vobek piqenë bashkë; Zoti (është) Bërësi këtyre të dyve.

<sup>3</sup> I urti sheh të keqenë që përpara, edhe fshihetë, po të marrëtë shkonjëne përpara, edhe mundonenë.

<sup>4</sup> Shpagesa e të përunjurit, edhe frika e Zotit, (është) pasëje, e lavdi, e jetë.

<sup>5</sup> Driza e kurthe (janë) mb' udhët të shtrembëtit; kush ruan shpirtin' e ti, do të jetë lark nga ato.

<sup>6</sup> Mëso dialënë ndë të nisurit të udhës' ati, edhe nukë do të largonetë nga ajo as kur të plakëtë.

<sup>7</sup> I pasuri urdhëron të vobeqtë; edhe ay që huhetë (është) shërbëtori i ati që huan.

<sup>8</sup> Kush mbiell panomi do të korrë mundime; edhe stapi i të sharit ati nukë do të hiqetë.

<sup>9</sup> Kush ka sy të mirë, do të bekonetë: sepse i ep të vobegut prej bukësë ti.

<sup>10</sup> Dëbo përqeshësinë, edhe do t'ikënjë qarta, edhe të zënëte' e të sharëtë do të pushonjëne.

<sup>11</sup> Kush do të qëruarët' e zemërësë, për hirin' e buzëvet ati mbëreti do të jetë miku i ati.

<sup>12</sup> Syt' e Zotit ruanjëne mëndëjenë, po punët' e të paudhit i kthen përmbys.

<sup>13</sup> Kush purton thotë: Leon (është) jashtë, do të vritem ndë mest të rrugavet.

<sup>14</sup> Gola e (gruasë) huajë është grop' e thellë; ay që mërëzetë prej Zotit, do të bierë brënda nd' atë.

<sup>15</sup> Marrëzia është lidhurë bashkë me zemërën' e çunit, stapi i mundimit do t'e ndanjë atë prej ati.

<sup>16</sup> Kush shtrëngon të vobegunë për të shtuarë pasëjen' e ti, edhe kush i ep të pasurit, me të vërtetë (do të ketë) nevolë.

<sup>17</sup> Vërë veshnë, edhe dëgjo fialët' e të urtëvet, edhe ngjit zëmërenë tënde pas mëndëjesë s'ime,

<sup>18</sup> sepse (janë) të ëmbëla, ndë i ruajç ndë zemërët tënde, edhe do të ngjitenë bashkë mbi buzët të tua.

<sup>19</sup> Që të kesh shpëresënë tënde mbi Zotinë, të mësova (këto) këtë ditë, po më fort ty.

<sup>20</sup> A nukë të shkrova ty shumë herë këshille e mënt,

<sup>21</sup> që të të bënj të njohç sigurin' e fialëvet vërteta, që t'u përgjegjesh fialë të vërteta atyreve që të dërgonjëne ty?

<sup>22</sup> Mos svish të vobegunë, sepse është i vobek, as mos shtrëngo fat-keqinë ndë portët,

<sup>23</sup> sepse Zoti do të vështronjë gjyqin' e atyreve, edhe do të sveshë shpirtin' e atyreve që sveshnë ata.

<sup>24</sup> Mos ki miqësi me njeri zemërak, as mos ecë bashkë me njeri zemërak,

<sup>25</sup> se mos xësh udhët' e ati, edhe bie ndë kurth shpirti yt.

<sup>26</sup> Të mos jesh nga ata që apënë dorënë, nga ata që bënenë dorë-dhënës për detyrë.

<sup>27</sup> Kur s'ke me se të lajsh, përse të marrënë shtratinë tënt (që ke) përposhtë?

<sup>28</sup> Mos çkul kufinj të vietërë, që kanë vënë atërit' e tu.

<sup>29</sup> A pe njeri që është' i zoti ndë punëratë të tia? Ay do të rri përpara mbëretëre, nukë do të rri përpara të poshtëre.

## KREI 23

<sup>1</sup> Kur të rrish të hash bashkë me bujar, vështro mirë (ato që kanë vënë) përpara teje,

<sup>2</sup> edhe vër-i thikënë qafësë s'ate, ndë je hamës.

<sup>3</sup> Mos dëshëro gjellët' e ati, sepse këto janë të ngrëna kobimi.

<sup>4</sup> Mos ki kujdes të bënesh i pasurë, hiq dorë prej mëntëjesë s'ate.

<sup>5</sup> A do të shtiesh sytë mbi atë gjë që s'është? Sepse (pasëja) bën me të vërtetë për vetëhen' e saj krahë, e fluturon ndë qiell posi shqiponjë.

<sup>6</sup> Mos ha bukën' e smir-keqit, as mos dëshëro gjellët' e ati,

<sup>7</sup> sepse sikundrë mendon ndë zemëret të ti, i këitllë është. Ha e pi, thotë ty, po zemëra e ati nuk' është bashkë me ty.

<sup>8</sup> Bukënë (që) hëngre do t'e vrellç, edhe do të humbasç ligjëratat' e ëmbëla.

<sup>9</sup> Mos i këshillo ndë vesht të marrit, sepse do të hedhë poshtë urtësin' e fialëvet tua.

<sup>10</sup> Mos çkul kufinj të vietërë, edhe mos shkel nd' arët të varfërëvet,

<sup>11</sup> sepse Shpërblimtari i atyre (është') i fortë; ay do të shikonjë gjyqin' e atyre kundrë teje.

<sup>12</sup> Ngjit zëmërenë tënde pas mësimit, edhe veshët' e tu pas fialëvet urtësisë.

<sup>13</sup> Mos u kurce të mësonjë dialënë, sepse ndë i rënç ati me shkop, nukë do të vdesë;

<sup>14</sup> tuke i rënë ati me shkop, do t'i shpëtonjë shpirtinë nga hadhi.

<sup>15</sup> Biri im, ndë u bëftë zëmëra jote e mënçëme, do të gëzonet' edhe zemëra ime;

<sup>16</sup> edhe veshnjet' e mia do të gëzonenë, kur të flasënë dreitë buzët' e tua.

<sup>17</sup> Zemëra jote le të mos u ketë zëli faltorëvet, po (ki) frikë Zotit gjithë ditënë,

<sup>18</sup> sepse me të vërtetë (është) shpagim, edhe shpëresa jote nukë do të këputetë.

<sup>19</sup> Pa dëgjo ti, o biri im, edhe bënu i urtë, edhe drejto zëmërenë tënde mb' udhët.

<sup>20</sup> Mos rri bashkë me verë-pirësit, as bashkë me plank-prishësit që hanë mish,

<sup>21</sup> sepse verë-pirësi edhe plank-prishësi do të bënenë të vobeq, edhe gjumashi do të vishetë me lecëka.

<sup>22</sup> Dëgjo-i t'-yt-et që të ka piellë, edhe mos e përçqesh t'et-ëmë, kur të plakëtë.

<sup>23</sup> Bli të vërtetënë, edhe mos e shit diturinë, e mësimnë, e urtësinë.

<sup>24</sup> I ati të dreitit do të gëzonetë fort, edhe kush piell (bir) të urtë, do të gëzonetë për atë.

<sup>25</sup> Yt-atë e jot-ëmë do të gëzonenë, po më fort do të gëzonet' ajo që të polli.

<sup>26</sup> Biri im, ep-më zëmërenë tënde, edhe syt' e tu le të shikonjëndë udhët' e mia,

<sup>27</sup> sepse kurva (është posi) grop' e thellë, edhe e huaja posi pus i ngushtë.

<sup>28</sup> Edhe ajo bën pritë posi kursar, edhe shton faltorëtë ndër njerëzit.

<sup>29</sup> Kush (është') i mierë? Kush psherëtin? Kush zihetë? Kush flet fialë të kota? Kush rrihetë pa ndonjë punë? Kush kuq sytë?

<sup>30</sup> Ata që ngrysenë ndë verët, ata që shkonjnë kohënë tuke kërkuarë verë të mirë.

<sup>31</sup> Mos vështro verënë se është e kuqe, se ngjyen qeftinë, se sbret shijazi.

<sup>32</sup> Më ndë funt kafshon posi gjarpër, thumbon posi beronjë;

<sup>33</sup> syt' e tu do të shikonjnë (gra) të huaja, edhe zemëra jote do të flasë (fialë) të paturpshime;

<sup>34</sup> edhe do të jesh posi ay që flë ndë kërhizët të detit, edhe posi ay që dirgjetë ndë majët të drusë lundrësë;

<sup>35</sup> (do të thuash) Më bininë, edhe nukë më dhëmpte, më rrihinë, edhe nukë ndinjam, kurë do të sgjonem, që të vete, e të kërkonj atë përsëri?

## KREI 24

<sup>1</sup> Mos u ki (zëli) njerëzet liq, as mos dëshëro të jesh bashkë me ata,

<sup>2</sup> sepse zemëra e atyreve shkon ndër mënt shtrëngim, edhe buzët' e atyre flasënë punë të këqia.

<sup>3</sup> Me anë të diturisë ndërtonetë shtëpia, edhe me anë të urtësisë forconetë.

<sup>4</sup> Edhe me anë të mëndëjesë do të mbushenë thesarëtë me ç' do gjë të paçimuarë e të gëzuarshime.

<sup>5</sup> Njeriu i mënçim ka forcë, edhe njeriu i urtë shton fuqinë.

<sup>6</sup> Sepse me anë të këshillevet mënçëme do të bëjsh luftënë tënde; edhe nga shumica e këshillëset (vien) shpëtimi.

<sup>7</sup> Dituria (është) fort e lartë për të marrinë, nukë do të hapë golën' e ti ndë portët.

<sup>8</sup> Ay që shkon ndër mënt të bënë keq, do të kluhetë keq-bërës.

<sup>9</sup> Mendimi i marrëzisë (është) fal; edhe përqeshësi (është) i ndohëtë ndër njerëzit.

<sup>10</sup> Ndë të raftë të hollëtë ndë ditë të keqe, fuqia jote (qënëka) e vogëlë.

<sup>11</sup> Shpëto ata që hiqenë për të vrarë, edhe mos u mërgo nga ata që janë gati për të therë.

<sup>12</sup> Ndë thënç: Na neve tek nukë dimë këtë, a nuk' e di ay që peshon zemëratë? Edhe ay që ruan shpirtinë tënt, edhe i ep gjithësecilit pas punëravet ati, (a nuk) e di?

<sup>13</sup> Biri im, ha mialtë, sepse (është) e mirë, edhe hojë mialte, (sepse është) e ëmbëlë ndë qiellëzët tënde;

<sup>14</sup> të këtilë (do të jetë) të kupëtuarët' e diturisë ndë shpirt tënt; kur të gjenjsh (atë), atëherë do të marrsh shpagim, edhe shpëresa jote nukë do të këputetë.

<sup>15</sup> Mos ngrih kurth, o i paudhë, atie ku rri i dreiti; mos trazo vëndin' e të prëjturit ati,

<sup>16</sup> sepse i dreiti rrëzonetë shtatë herë, edhe ngrihetë, po të paudhëtë do të bienë ndë humbje.

<sup>17</sup> Mos u gëzo ndë të rrëzuarët të arëmikut tënt, edhe le të mos gëzonetë zemëra jote ndë të shkarët t' ati,

<sup>18</sup> se mos shohë Zoti, e i duket' e keqe ndër sy t' ati, e kthen zemërimin' e ti mbi atë.

<sup>19</sup> Mos të duketë e ligë ndër sy për njerëzit' e liq, as mos u ki zëli të paudhëvet,

<sup>20</sup> sepse i ligu nukë do të ketë funt (të mirë), kandilëj' e të paudhëvet do të shuhetë.

<sup>21</sup> Biri im, ki frikë Zotit edhe mbëretit, (edhe) mos u përziej me ata që ngrenë krye,

<sup>22</sup> sepse e liga e atyre do t'ua harinjë papandehurë; edhe kush e di prishëjen' e atyre të dyve?

<sup>23</sup> Edhe këto (punë) janë për të diturit. Të mbajturit' anë ndë gjyq nuk' është të mirë.

<sup>24</sup> Atë që i thotë të paudhit: Je i drejtë, këtë gjëndëjetë do t'ë mallëkonjë, edhe kombetë do t'i kenë të ndohëtë,

<sup>25</sup> po ndër ata që e qërtonjë në do të jetë hirë, edhe urimi i të mirëvet do të vinjë mbi ata.

<sup>26</sup> Kush përgjegjetë fialë të dreita, puth buzëtë.

<sup>27</sup> Ndrej punë të tēnde jashtë, edhe bën-e gati për vetēhenë tēnde nd' arēt, edhe pastaj ndërto shtëpinë tēnde.

<sup>28</sup> Mos u bën deshmitar i paudhë kundrë t'afërmit tënt, as mos gënjej me buzët' e tua.

<sup>29</sup> Mos thuash: Sikundrë më bëri mua, kështu do t'i bënj ati, do t'ja shpaguej njeriut pas punës' ati.

<sup>30</sup> Shkonjam ndëpër arē të purtesēsit, edhe ndëpër vēshtë t'ati që s'ka mënt,

<sup>31</sup> edhe na tek kishinë mbirë gjēmba kudo: hithēsāt' i kishinë mbuluarē faqenē, edhe muri i gurtë ishte rrēzuarē.

<sup>32</sup> Atēherē unē tuke vënë re, u menduash ndē zemērēt t'ime: pashē, (edhe) xura.

<sup>33</sup> Tuke fjetur' (edhe) pak, tuke marr' (edhe) pak gjumē, tuke mpshtiehtë duartē ndē gjumēt,

<sup>34</sup> vien vobezia jote posi këmbēsuar i shpejtē, edhe nevola jote posi burr i armatosurē.

## KREI 25

<sup>1</sup> Edhe këto (janë) fialët' e urta të Sollomonit, që mbëllojnë njerëzit' e Ezeqit, mbëretit Judhēsē.

<sup>2</sup> Lavdia e Perëndisë (është) të mbulonjë kafshënë, edhe lavdia e mbëretëret (është) të gjenjë kafshënë.

<sup>3</sup> Të lartët' e qiellit, e të thellët' e dheut, e zemëra e mbëretëret s'kanë të kërkuarē.

<sup>4</sup> Hiq ndryshkunë nga argjëndi, edhe do të dalë enë te argjëndari;

<sup>5</sup> hiq të paudhëtë prej sysh mbëretit, edhe fronit i ati do të forconetë ndē dreitëri.

<sup>6</sup> Mos u mburr përpara mbëretit, edhe mos rri ndē vënt të mëdhenjet,

<sup>7</sup> sepse më mirë (është) të të thonë: Hip këtu, se të sbreç përpara sysh të madhit, që panë syt' e tu.

<sup>8</sup> Mos shko shpejt të zihesh, mbase nukē (di se) ç'të bëjsh më ndē funt, kur të të turpëronjë i afërmi yt.

<sup>9</sup> Ndrej gjyqinē tënt (vetëmē) bashkë me të afërminē tënt, edhe mos sbulo të fshehtënenë te tiatri,

<sup>10</sup> se mos të shanjë ay që dëgjon, edhe nukē hiqetë turpëria jote.

<sup>11</sup> Fiala që flitetë tek ka vëndinë është (posi) mollë t'arta ndër enē t'argjēntta.

<sup>12</sup> Posi vëthē t'arhtë, edhe posi stoli prej ari të këthiellëtē, (është') i urti që qërton veshn' e dëgjuarshim.

<sup>13</sup> Posi të ftohëtit' e borēsē ndē kohē të korrit, (kështu është) i lajmi besëtar tek ata që e dërgonjë, sepse prën shpirtet' e të zotëret ti.

<sup>14</sup> Kush mburretë për dhurëtin' e gënjeshtë (i gjan) resē e erēsē pa shi.

<sup>15</sup> Zotërisē i mbusetë mēndēja nga durimi; edhe gluh' e ëmbëlē thyen eshtëra.

<sup>16</sup> Gjete mjaltē? Mos ha tepërē, se mos fryhesh tepërē nga ajo, edhe ta viellsh.

<sup>17</sup> Rrallē vërē këmbënë tēnde ndē shtëpit të afërmit, se mos rëndonetē e të mērëzintjē.

<sup>18</sup> Ay njeri që deshmon deshmi të rreme kundrë të afërmit ti, (është posi) kopaçē, e (posi) thikē, e (posi) shëgjet' e hollē.

<sup>19</sup> Besa e të pabesit ndē ditē të zezē, (është posi) dhëmb' i kalburē, e (posi) këmb' e dalē vëndit.

<sup>20</sup> (Posi) ay që svesh robënë ndë kohë të ftohëtë, (e posi) uthëlla mbi nitrët, kështu (është) ay që i këndon kënkë zëmërësë helmuarë.

<sup>21</sup> Ndë ka uri arëmiku yt, ep-i bukë të hajë, edhe ndë ka et, ep-i ujë të pijë,

<sup>22</sup> sepse do të grumbullonç thëngjij zjarri mbi kryet t'ati, edhe Zoti do të ta shpagueanjë.

<sup>23</sup> Er' e borësë dëbon shinë, edhe faqëja e vrërëtë gluhënë që pështëllin.

<sup>24</sup> Më mirë të rrijë (njeriu) ndë çip të kasollësë, se ndë shtëpi të madhe bashkë me grua që i k'ënda të zihetë.

<sup>25</sup> (Posi) ujët' e ftohëtë ndë shpirt të eçim, kështu (është) zër' i mirë nga dheu i largë.

<sup>26</sup> I dreiti kur fëlen përpara të paudhit (është) posi gjurr' e trubullë, e (posi) kroi i prishurë.

<sup>27</sup> (Sikundrë) nuk' (është) mirë të hajë njeri shumë mjaltë, kështu (nuk' është) mirë të kërkonjë lavdin' e ti.

<sup>28</sup> Kush nukë përmba shpirtin' e ti, (është) posi) qytet i rrëzuarë, e pa mur.

## KREI 26

<sup>1</sup> Posi bora ndë verë, edhe posi shiu ndë të korrët, kështu nuk' i ka hie nderi të marrit.

<sup>2</sup> Sikundrë silletë zogu, sikundrë fluturon dellandysheja, kështu s'ka për të harriturë mallëkimi i paudhë.

<sup>3</sup> Shufra (është) për kalënë, frëri për gomarinë, edhe shkopi për kurrizin' e të marrëvet.

<sup>4</sup> Mos iu përgjeq të marrit pas marrëzis' ati, që të mos bënesh edhe ti shoqi i ati.

<sup>5</sup> Përgjegjju të marrit pas marrëzis' ati, që të mos jet' i urtë ndër syt t'ati.

<sup>6</sup> Kush dërgon gjëmë me dorë të marrit, pret këmbët' (e tia) edhe pi dëm.

<sup>7</sup> (Posi) shalët' e të çalit që varenë padobi, (kështu është) edhe fial' e urtë ndë golët të marrëvet.

<sup>8</sup> Posi ay që lith gurë ndë hobet, kështu është ay që i bën nderë të marrit.

<sup>9</sup> (Posi) gjëmbi që nguletë ndë dorët të dejturit, kështu (është) edhe fial' e urtë ndë golët të marrëvet.

<sup>10</sup> Njeriu i math ndyr të gjitha, edhe pajton të marrëtë, pajton edhe nom-prishësitë.

<sup>11</sup> Posi qëni që kthenetë ndë të viellët të ti, (kështu edhe) i marri kthenetë ndë marrëzit të ti.

<sup>12</sup> A pe njeri që kujton vetëhen' e ti të urtë? Më tepërë shpëresë është nga i marri, se nga ay.

<sup>13</sup> Kush purton thotë: Leon (është) mb' udhë, leon (është) ndëpër rrugat.

<sup>14</sup> Posi dera që silletë mbi boshtet të saj, kështu (sillet' edhe) ay që purton mbi shtrat të ti.

<sup>15</sup> Ay që purton ngjyen dorën' e ti ndë kupët, (edhe) rëndonetë ta shpierë atë ndë golët të ti.

<sup>16</sup> Ay që purton kujton vetëhen' e ti më të urtë se shtatë të urtë që apënë mënt.

<sup>17</sup> Kush shkon udhësë edhe përzihetë ndë qartë që nuk' i (përpiek) ati, (i gjan) ati që zë qënë për veshësh.

<sup>18</sup> Posi i çëmënduri që heth flakë, shëgjeta, e mort,

<sup>19</sup> kështu është ay njeri që gënjen t'afërminë, edhe thotë: A nuk' (e bëra) unë (këtë) tuke lozurë?

<sup>20</sup> Tek s'ka dru zjarri shuhetë, edhe tek s'ka pështëllonjës qarta pushon.

<sup>21</sup> Thëngjijtë (janë) për prushinë, edhe drutë për zjarrinë, edhe ay njeri që do qarta është për të dhezurë qarta.

<sup>22</sup> Fialët' e pështëllonjësit përpihen' ëmbëlë, edhe sbresënë përbrënda barkut.



<sup>23</sup> Buzët' e dhezura edhe zëmëra e keqe, (janë posi) ndryshk argjëndi lyerë mbi enë të balltë.

<sup>24</sup> Kush mërzit, e mpsheh me buzët e tia, edhe mendonetë kobim ndë zemërët të ti.

<sup>25</sup> Kur flet me buzë mbë gaz, mos i beso, sepse ka shtatë (palë) ndyrësira ndë zemërët të ti.

<sup>26</sup> (Kush) mbulon të mërzituritë me kobim, dreqësia e ati do të çfaqetë ndë mest të përmbëledhëjesë.

<sup>27</sup> Kush rëmon gropë do të bierë nd' atë, edhe guri do të kthenetë mbi atë që e rrukullis.

<sup>28</sup> Gluha e rreme mërzit ata që shtrëngonenë nga ajo, edhe gola gënjeshtare punon prishëje.

## KREI 27

<sup>1</sup> Mos u mburr për ditën' e nesërme, sepse nukë di se ç'do të piellë dita.

<sup>2</sup> Le të të lavdëronjë tiatri, e mos gola jote, i huaji, e mos buzët' e tua.

<sup>3</sup> Guri (është) i rëndë, edhe rëra s'mbare të, po zemërimi i të marrit (është) më i rëndë se të dyja.

<sup>4</sup> Mëria (është) e ashpërë, edhe zemërata e hollë, po kush munt të qëndronjë përpara zëlisë?

<sup>5</sup> Qërtimi i çfaqurë (është) më i mirë se dashuria e fshehurë.

<sup>6</sup> Plagët' e mikut (janë) të besësë, po të puthurat' e arëmiqet (janë) të panumëruara.

<sup>7</sup> Shpirtit nginjurë s'i ka ënda mjaltë hoje, po shpirtit urishim ç'do gjë e hidhurë (i vien) e ëmbëlë.

<sup>8</sup> Posi zogu i mërguarë nga folej' e ti, kështu (është) njeriu i mërguarë nga vëndi i ti.

<sup>9</sup> Valëratë me erë e thimiamatë gëzonjënë zemërënë, edhe të ëmbëlët' e mikut prej këshillesë zemërësë.

<sup>10</sup> Mos hiq dorë nga miku yt, e nga miku i t'yt-et, edhe të mos hynjë ndë shtëpit të t'yt-vëllaj (kur gjënde) ndë ditë të zezë, (sepse) më i mirë (është) fëqiri i afërm, se vëllaj i largë.

<sup>11</sup> Biri im, bënu i urtë, gëzo zemërënë t'ime, që të kem se ç't'i përgjegjem ati që më shan.

<sup>12</sup> I urti sheh të ligënë që përpara (edhe) fshihetë, (po) të marrëtë venë pas, (edhe) mundonenë.

<sup>13</sup> Merr rrobën' e dorë-zënësit (për) të huajë, edhe merr penk prej ati, për të huaja.

<sup>14</sup> Kush ngrihetë ndë mëngjes edhe bekon me zë të math të afërmin' e ti, do të numëronetë si ai që e mallëkon.

<sup>15</sup> Posi pika që s'pushon ndë ditët të shiut, (kështu është) edhe ajo grua që i ka ënda të zihetë;

<sup>16</sup> kush fsheh atë, fsheh erënë; edhe vali me erë (që fshihetë) ndë të diathtë t'ati klëthet.

<sup>17</sup> Hekuri preh hekurinë, edhe njeriu preh faqen' e mikut ti.

<sup>18</sup> Kush ruan drurin' e fikut do të hajë pemë nga ay, edhe kush ruan të zonë do të nderonetë.

<sup>19</sup> Sikundrë nd' ujët faqeja (sheh) faqenë, kështu edhe zemëra e njeriut te njeriu.

<sup>20</sup> Hadhi edhe prishëja s'kanë të mbushurë, edhe syt' e njeriut nukë mbushenë.

<sup>21</sup> Argjëndi (shprovetë) nga të shkrirëtë, edhe ari nga kamina, po njeriu nga gola e atyreve që e lëvduronjënë.

<sup>22</sup> Edhe ndë shtypsh të marrin me shtypësinë ndë shtypec ndë mest të grurit shtypurë, marrëzia e ati nukë do të ndahetë prej ati.

<sup>23</sup> Shiko të dish se si janë tufat' e dhënet tu, edhe ki-ju kujdes mirë lopëvet,

<sup>24</sup> sepse gjëja nukë (qëndron) kurdo, as kurora bres pas brezi.

<sup>25</sup> Bari mbin, edhe bari i ngjomë përtërihetë, edhe barërat' e malevet mbëlidhenë.

<sup>26</sup> Shqëratë (janë) për rrobat' e tua, edhe sqepëtë për pagën' e arësë.

<sup>27</sup> Edhe do të kesh mjaft klumësht dhish për të ngrënë të t'at, për të ngrënë të shtëpisë s'ate, edhe për jetën' e shërbëtorevet tua.

## KREI 28

<sup>1</sup> Të paudhëtë ikënjënë pa i ndiekurë njeri, po të dreitëtë kanë zemërë posi leon.

<sup>2</sup> Për falet e vëndit (janë) shumë krerë, po me anë të njeriut urtë e të mënçim do të sgjatonetë mbëretëria.

<sup>3</sup> Njeriu i vobek që shtrëngon të vobeqtë, (është) posi shiu i rëndë që nuk' ep bukë.

<sup>4</sup> Ata që lënë nomnë, lavdëronjënë të paudhëtë, po ata që ruanjënë nomnë lëftonjënë me ata.

<sup>5</sup> Njerëzit' e liq nukë do të kupëtonjënë gjyq, po ata që kërkonjënë Zotinë do të kupëtonjënë të gjitha.

<sup>6</sup> Më i mirë (është) i vobegu që ecën ndë të dreitët, se ay që është i shtrembëtë mb' udhët, ndonëse është i pasurë.

<sup>7</sup> Kush ruan nomnë (është) dial' i urtë, po miku i plënk-prishëset turpëron tanë.

<sup>8</sup> Kush shton pasëjën' e ti prej uzuresë e prej lakëmimit, e mbëleth për atë që përdëllen të vobeqtë.

<sup>9</sup> Ay që kthen mbë-nj'-anë veshin' e ti nga të dëgjuarët' e nomit, edhe ata të falurit' e ti (do të jetë) të ndohëtë.

<sup>10</sup> Kush shpie të dreitëtë mb' udhë të ligë, ay vetë do të bierë ndë gropët të ti, po faqe-bardhëtë do të trashëgonjënë të miratë.

<sup>11</sup> Njeriu i pasurë kujton vetëhen' e ti të diturë, po i vobegu i mënçim e qërton atë.

<sup>12</sup> Kur fitonjënë të dreitëtë, (është) lavdi e madhe, po kur lartonenë të paudhëtë, njerëzitë fshihenë.

<sup>13</sup> Kush fsheh falet' e tia nukë do të venjë mbarë, po kush i rrëfen edhe heq dorë, do të përdëllehetë.

<sup>14</sup> Lum ay njeri që ka frikë përherë, po kush ashpëron zemërën' e ti, do të bierë keq.

<sup>15</sup> Leoni që ulurin, edhe ariu që ka uri, (është) si i paudhi që urdhëron gjëndëje të vobegë.

<sup>16</sup> Ay zotëri që s'ka mënt, shton shtrëngatatë, po ay që uren rrëmbullënë do të sgjatonjë dit' (e tia).

<sup>17</sup> Ay njeri që është faltuar për gjak njeriu, do të shpejtonjë ndë gropët, asndonjë nukë do t'e mbanjë atë.

<sup>18</sup> Kush ecën ndë të dreitët, do të shpëtonjë, po i shtrembëti nd' udhët do të bierë përnjëherë.

<sup>19</sup> Kush punon dhen' e ti, do të nginjetë me bukë, po kush u bie prapa njerëzet kotë, do të mbusetë me vobezi.

<sup>20</sup> Njeriu besëtar (do të ketë) shumë bekim, po kush nxiton të bënëti' i pasurë, nukë do të mbesë pa munduarë.

<sup>21</sup> Njeriu t'i mbajë anë tiatrit nuk' është mirë, sepse (i këtilli) njeri do të punonjë paudhë për një copë bukë.

<sup>22</sup> Kush ka sy të lik nxiton të bënëti' i pasurë, edhe nuk' e di se nevola do të vinjë mbi atë.

<sup>23</sup> Kush qërton njerinë, pastaj do të gjënjë më tepërë hirë, se atë që përkëdhel me gluhë.

<sup>24</sup> Kush vieth tanë a t'ëmënë, edhe thotë: Nuk' është fal, ay është shoqi i kursarit.

<sup>25</sup> Kush është madhështuar ndë zemëret ndes qarta, po kush shpëren mbë Zotinë do të mahetë.

<sup>26</sup> Kush shpëren mbë zemëret të ti, është' i marrë, po kush ecën me urtësi, ky do të shpëtonjë,

<sup>27</sup> Kush u ep të vobegjet, nukë do të ketë nevolë, po kush kthen sytë mbë-nj'-anë, do të (ketë) shumë mallëkime.

<sup>28</sup> Kur lartonetë të paudhëtë, njerëzitë fshihenë, po ndë humbëjet të tyre, të dreitëtë shtonenë.

## KREI 29

<sup>1</sup> Ay njeri që bënetë kokë-trashë kur qërtonetë, do të humbasë papandehuraj, edhe pa shërim.

<sup>2</sup> Kur madhëronenë të dreitëtë, gjëndëja gëzonetë, po kur urdhëron i paudhi, gjëndëja psherëtin.

<sup>3</sup> Kush do urtësinë, gëzon tanë, po kush përzihetë me kurva, prish pasëjen' (e ti).

<sup>4</sup> Mbëreti forcon vëndinë me anë të dreitërisë, po kush merr mitë, e prish atë.

<sup>5</sup> Ay njeri që përkëdhel t'afërmin' e ti, nden rrietë përpara çapavet ati.

<sup>6</sup> Njeriu i lik zihetë ndë të shtrembëtët, po i dreiti këndon e gëzonetë.

<sup>7</sup> I dreiti njuh gjyqin' e të vobegut, po i paudhi nukë di të njohurë.

<sup>8</sup> Njerëzitë përqeshës i apënë flakë qytetit, po të urtëtë kthenjënenë mbë-nj'-anë zemëriminë.

<sup>9</sup> Njeriu i urtë kur hahet me njerin' e marrë, ndo kur zemëronetë, ndo kur qesh, nukë gjen të prëjturë.

<sup>10</sup> Njerëzitë gjakëtorë mërëzitinjënenë të dreitinë, po të dreitëtë kërkonjënenë jetën' e ati.

<sup>11</sup> I marri çfaq gjithë zemëren' e ti, po i urti e përmba atë prapazi.

<sup>12</sup> Ay që urdhëron ndë u mbajtë vesh fialëvet rreme, gjithë shërbëtorët' e ati (bënenë) të këqij.

<sup>13</sup> I vobek edhe hua-dhënës përpiqenë bashkë: Zoti u ndrit sytë të dyve.

<sup>14</sup> Mbëreti kur gjykon dreitë të vobeqtë, froni i ati do të forconetë për kurdo.

<sup>15</sup> Shkopi edhe qërtimi apënë dituri, edhe diali i lëshuarë turpëron t'ëmënë.

<sup>16</sup> Kur shumonenë të liqtë, shtonet' e liga, po të dreitëtë kanë për të parë të rrëzuarët' e atyre.

<sup>17</sup> Mundo t'ët-bir, edhe do të t'apë të prëjturë, edhe do t'i apë gëzim shpirtit tënt.

<sup>18</sup> Atie tek s'ka të faniturë, gjëndëja baretë, po ay që ruan nomnë, është' i lumurë.

<sup>19</sup> Shërbëtori nukë ndreqetë me fialë, sepse kupëton, po nukë dëgjon.

<sup>20</sup> A pe njeri të shpejtë mbë fialët? Më tepërë shpëresë është mbë të marrinë, se mb' atë.

<sup>21</sup> Ndë rittë ndonjë shërbëtorin' e ti që së vogëli me të butë, më ndë funt do të bënetë bir.

<sup>22</sup> Njeriu zemërak dhes qarta, edhe njeriu i mërishëm shton të ligatë.

<sup>23</sup> Madhështia e njeriut do t'e përunjë atë, po zemër-unjurin' e nderonjënenë.

<sup>24</sup> Kush ndan bashkë me kursarinë, uren shpirtin' e ti, dëgjon benë, edhe nukë rrëfen.

<sup>25</sup> Frika e njeriut ngreh kurth, po kush shpëren mbë Zotinë do të vihetë lart ndë siguri.

<sup>26</sup> Shumë vetë kërkonjënenë syt' e mbëretit, po gjyqi i njeriut (është) prej Zotit.

<sup>27</sup> Njeriu i paudhë (është) i ndohëtë ndër të drejtët; edhe i dreiti mb' udhët, është i ndohëtë ndër të paudhët.

## KREI 30

<sup>1</sup> Fialët' e Agurit, të birit Jakehut, (do me thënë) profitia që i foli njeriu lthiilit, lthiilit edhe Ukalit.

<sup>2</sup> Me të vërtetë unë jam më i marri i njerëzet, edhe urtësi njeriu nukë (gjëndetë) tek unë;

<sup>3</sup> edhe nukë xura diturinë, as nukë di mëndëjen' e kafshavet shënjtëruara.

<sup>4</sup> Cili hipi ndë qiell edhe sbriti? Cili mbëlodhi erënë ndër duart të tia? Cili lidhi ujëratë ndë rrobët? Cili forcoi gjith' anët' e dheut? Ç' (është) emëri i ati? Edhe ç' (është) emëri i të birit, ndë e di?

<sup>5</sup> Ç' do fialë Perëndie është e provuarë, është mburonjë ndër ata që shpërenjë në mb' atë.

<sup>6</sup> Mos shto gjë ndër fialët' t'ati, se mos të provonjë, edhe del gënjeshtar.

<sup>7</sup> Dy kafsha kërkonj prej teje, mos m'i mohonjç (këto) përpara se të vdes:

<sup>8</sup> të mërgonjç prej meje kotësi e fialë të rreme; të mos më apsh vobezi e gjë; ushqe-më me pak ushqim:

<sup>9</sup> se mos nginjem, e të mohonj, e them: Ç' (është) Zoti? A se mos ndodhem i vobek, e vieth, e zë emërin' e Perëndisë t'im (mbë të kotë).

<sup>10</sup> Mos zërë n'golë për të keq shërbëtorinë tek i zoti, se mos të mallëkonjë, e të zë fali.

<sup>11</sup> (Ka) bres që mallëkon tanë, edhe nukë bekon t'ëmënë.

<sup>12</sup> (Ka) bres të këthiellëtë ndër syt të ti, po nuk' është larë nga ndyrësira e ti.

<sup>13</sup> (Ka) bres, të cilit sa të lartë janë sytë, edhe (sa) të ngriturë janë qepallat' e ati!

<sup>14</sup> (Ka) bres, të cilit dhëmbëtë (janë) kordha, edhe dhëmballëtë thika, që të brenjë në të vobeqtë prej dheut, edhe të nevolëshimitë prej njerëzish.

<sup>15</sup> Piaveca ka dy bila, (që thërrasënë): Bierë, bierë. Këto të tria s'kanë të nginjurë (kurrë, po më fort këto) të katrëta nukë thonë (kurrë): Mjaft.

<sup>16</sup> Varri, edhe shtrati i shterpësë: dheu (që) nukë nginjetë me ujë, edhe zjarri (që) nukë thotë: Mjaft.

<sup>17</sup> Syri që përqesh tanë, edhe nukë do t'i dëgjonjë s'ëmësë, korbat' e shkëmbit do ta hedhënë tej, edhe zoq' e shqiponjavet do ta hanë.

<sup>18</sup> Këto të tria janë të çudiçime tek unë, po më fort katër kafsha nukë kupëtonj:

<sup>19</sup> Gjurma' e shqiponjësë ndë qiell, gjurma' e gjarpërit mbi shkëmt, gjurma' e lundrësë ndë mes të detit edhe gjurma' e njeriut ndë të rit.

<sup>20</sup> E këthillë (është) udha e kurvësë: ha, e mpshin buzët' e saja, edhe thotë: Nukë bëra ndonjë punë të paudhë.

<sup>21</sup> Për tri (punë) përzihetë dheu, po më fort për katër, (të cilatë) nukë munt të duronjë:

<sup>22</sup> për shërbëtorinë, kur mbëretëron; për të marrinë, kur nginjetë me bukë;

<sup>23</sup> për (gruan') e mërziurë, kur martonetë, edhe për shërbëtorenë, kur sbon të zonjë në.

<sup>24</sup> Këto të katrëta (janë) fort të vogëla mbë dhet, po janë fort të mënçime:

<sup>25</sup> Melingonjatë, (që janë) një gjëndëje e pafuqishime, po ndë verë bënë një gati të ngrënë' e tyre;

<sup>26</sup> Iepujtë, që janë një gjëndëje e pafuqishime, po bënë një shtëpit' e tyre mbi shkëmt;

<sup>27</sup> karkalecatë, që s'kanë mbëret, po të gjithë dalënë bashkë tufë tufë;

<sup>28</sup> mirmanga (që) mbahetë për këmbësh, edhe rri ndëpër pallatet të mbëretëtret.

<sup>29</sup> Këto të tria ecënë mirë, po më fort katër ecënë hieshim:

- <sup>30</sup> Leoni (që është) më i forti i shtëzet, edhe nukë kthenetë nga syt' e ndonjëj;  
<sup>31</sup> gjeli, edhe sqapi, edhe mbëreti, që është qarkuarë nga gjëndëja e ti.  
<sup>32</sup> Ndë paç punuarë pa mënt tuke lartuarë vetëhenë tënde, edhe ndë paç menduarë (keq, vërë) dorënë mbi golët.  
<sup>33</sup> Sepse kush rreh klumësht, nxier gjalpë, edhe kush shtrëngon hundënë, nxier gjak; edhe kush dhes zëmërim, nxier të zëna.

## KREI 31

- <sup>1</sup> Fialët' e mbëretit Lemuil, profitia që i mësoi e ëma.  
<sup>2</sup> Ç'(është), biri im? Edhe ç'(është), dial' i barkut t'im? Edhe ç'(është), biri i uratavet mia?  
<sup>3</sup> Mos i apsh fuqinë tënde gravet, as udhët' e tua atyreve që prishnjënë mbëretëritë.  
<sup>4</sup> Nuk' (është) për mbëretëritë, o Lemuil, nuk' (është) për mbëretëritë të pinë verë, as për zotërinjtë (të pinë) të pira të forta,  
<sup>5</sup> se tuke pirë mos harronjëne nomnë, edhe shtrëmbëronjëne gjyqin' e ati që shtrëngonetë.  
<sup>6</sup> Epuni të pira të forta atyre që janë të shtrënguarë, edhe verë atyre që kanë helmuarë shpirtinë,  
<sup>7</sup> që të pinë e të haronjëne vobezin' e tyre, edhe mos kujtonjëne më fatin' e tyre të zinë.  
<sup>8</sup> Hap golënë tënde për të pagolinë, për gjyqin' e gjith' atyre që janë të lënë.  
<sup>9</sup> Hap golënë tënde, edhe gjuko dreitë, edhe mburo të vobegunë e të nevolëshiminë.  
<sup>10</sup> Kush munt të gjenjë grua të mirë? Sepse e këtilla (është) shumë më e vëlyerë se margaritarëtë.  
<sup>11</sup> Zemëra e burrit asaj shpëren mb' atë, edhe nukë do t'i shteretë gjë nga të shumatë.  
<sup>12</sup> Do t'i bierë ati të mira, e jo të këqia, gjithë dit e jetësë saj.  
<sup>13</sup> Kërkon lesh e li, edhe i k'ënda të punonjë me duart' e saja.  
<sup>14</sup> Është posi lundra e tregjetarëvet: bie ushqimnë e saj për së largu.  
<sup>15</sup> Edhe ngrihetë kur është po natë, edhe ep të ngrënë ndë shtëpit të saj, edhe punë shërbëtorevet saja.  
<sup>16</sup> Vështron arë, edhe e blen, edhe vë vështë nga puna e duaret saja.  
<sup>17</sup> Ngjesh mezin' e saj me fuqi, edhe forcon krahët' e saj.  
<sup>18</sup> Ndien se tregjetia e saj është e mirë; kandilëj e saj nukë shuhetë natënë.  
<sup>19</sup> Vë dorën' e saj ndë bosht, edhe mba ndë dorë të saj furkënë.  
<sup>20</sup> Hap dorën' e saj ndër të vobëqt, edhe nden duart' e saja ndër të nevolëshëmit.  
<sup>21</sup> Nuk' i ka frikë borësë për shtëpin' e saj, sepse gjithë shtëpia e asaj është veshurë me dy palë të veshura.  
<sup>22</sup> Bën mbulesa për vetëhen' e saj; rroba e asaj (është) vishnje edhe e kuqe.  
<sup>23</sup> Burri i asaj njihetë ndër portat, kur rri ndë mest të pleqvet vëndit.  
<sup>24</sup> Bën pëlhurë të hollë, edhe e shet, edhe u ep breza tregjetarëvet.  
<sup>25</sup> (Është) veshurë me fuqi e me bukuri, edhe gëzonetë për motinë që vien.  
<sup>26</sup> Hap golën' e saj me urtësi, edhe mbi gluhë t'asaj (është) nom dashurie.  
<sup>27</sup> Rri sguarë ndë qiveri të shtëpisë saj, edhe nukë ha bukë purtese.  
<sup>28</sup> Djemt' e asaj ngrihen' edhe e lavdëronjëne, po edhe burri i asaj e lavduron.  
<sup>29</sup> Shumë bila kanë qënë të vëlyera, po ti i kapërceve të gjitha.  
<sup>30</sup> Hiri (është) i rrem, edhe bukuria e kotë, po gruaja që i ka frikë Zotit, ajo do të lavduronetë.

<sup>31</sup> Epni asaj prej pemësë duaret asaj, edhe punët' e asaj le ta lavdëronjën' atë ndër portat.